

**Universiteti Europian i Tiranës**  
**RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
“Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja”  
i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i  
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. Assoc. Dr. Ervis Iliazaj
2. Dr. Anjeza Xhaferraj
3. Florian Çullhaj PhD
4. Vilma Beqa (Studente)

Nëntor, 2019

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM**

### **Përshkrim përmbledhës**

Programi i Përbashkët Master i Shkencave në Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja (Political Science: Integration and Governance, tani e në vazhdim PoSIG), është zhvilluar si pjesë e Projektit Erasmus+ KA2 për Ngritjen e Kapaciteteve, Projekti 561485 - 2015-2017, "Zhvillimi i Kurrikulës së Përbashkët në Master i Shkencave Politike Evropiane (MShPE)".

Programi është licencuar me Urdhër të Ministrit Nr. 302, datë 01.06.2018, si programi i ciklit të dytë, Master i Shkencave, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Në përfundim të programit lëshohet diplomë e përbashkët nga 2 deri në 4 institucione partnere të konsorciumit të universiteteve bashkëpunuese në projekt, ku Universiteti European i Tiranës bashkëpunon me:

1. Universiteti i Salzburgut, Austri, lider i projektit
2. Universiteti i Lubjanës, Slloveni
3. Universiteti "SS. Cyril and Methodius", Shkup, Maqedoni e Veriut
4. Kolegji Fama, Kosovë
5. Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë, Kosovë
6. Universiteti i Sarajevës, Bosnjë dhe Hercegovinë
7. Shkolla e Sarajevës për Shkencë dhe Teknologji, Bosnjë dhe Hercegovinë
8. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Shqipëri.

Programi i studimit është i akredituar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin në Austri (Agency for Quality Assurance and Accreditation, Austria) për periudhën 6 vjeçare (15 mars 2017 deri më 14 Mars 2023), për të nisur zbatimin e tij në vitin akademik 2017-2018.<sup>1</sup> Duke qenë se në bazë të legjislacionit shqiptar, ky akreditim nuk u konsiderua i mjaftueshëm nga Ministria përgjegjëse për arsimin, UET ngriti grupin e vlerësimit të brendshëm, në zbatim të procedurave vendase për të hartuar raportin në kuadër të zhvillimit të procesit të vlerësimit të jashtëm vendas.

Në kuadër të marrëveshjes me institucionet partnere, viti i parë i studimeve ndiqet në një nga institucionet perëndimore (Universiteti i Salzburgut ose Universiteti i Lubjanës) dhe gjatë viti të dytë të studimeve, studenti ka të drejtë të zgjedhë 1-2 institucione të tjera të rajonit, për të përmbyllur pjesën tjetër të detyrimeve akademike të programit të studimit. Programi është hapur në vitin 2017-2018 me regjistrimet e para të studentëve në Universitetin e Salzburgut, Austri.

---

<sup>1</sup> AQ\_Confirmation\_PoSiG\_condition\_decision, dokumenti i akreditimit të programit të studimit në Austri, përpara hapjes së tij në vitin 2017-2018. (Ref. Nr. 54)

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (më poshtë do të quhet Raporti) hartohet në përmbushje të detyrimeve të Universitetit European të Tiranës për akreditimin e parë të programit Master i Shkencave në Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja, (më poshtë do të quhet PoSig), pjesë e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Grupi i vlerësimit të brendshëm për përpilimin e këtij raporti është ngritur me Urdhër të Rektorit, Nr. 3, datë 04.03.2019, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UET. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB është patur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin. Grupi ka në përbërje të tij tri pedagogë dhe një student. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit (grup ad hoc). Ai ka të përcaktuar një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.) dhe një shpërndarje të qartë detyrave.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave “Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja” (PoSIG)

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/ “Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i përbashkët i studimit Master i shkencave PoSIG jo vetëm nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por madje përbën një nga nismat e pakëta në vend, që synon ndërkombëtarizimin e diplomave të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në vend. Arsimit të lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi, modeli sipas së cilit universitetet po bëhen burimi i shpërndarjes së profesionalizmit dhe etikës qytetare në rajonin Ballkanik. <sup>2</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Po, ky program synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Për më tepër, duke qenë se është një program ndërkombëtar, ky program ka në fokus përvetësimin e praktikave më të mira rajonale dhe Europiane dhe integrimin e tyre në realitetin akademik e kulturor kombëtar si dhe në përputhje me Nenin 6-të të Statutit të UET-it. <sup>3</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Po, programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit bazuar në Statutit të UET-it si dhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor (2017-2020). Për UET-in, kërkimi shkencor dhe inovacioni janë një gur themeli dhe pjesë kryesore e strategjisë së zhvillimit institucional. Për të kryer një kërkim shkencor në nivelin më të lartë dhe të orientuar drejt politikave publike, Universiteti European i Tiranës bazohet në gamën e gjerë të ekspertizës që ka në shkencat sociale, humane, ekonomike, teknologjitet e informacionit, edukimit, komunikimit, i xhinierisë, arkitekturës, arteve liberale si dhe shkencave mjekësore teknike. Në veçanti, UET-i është i fokusuar në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimin e portofolit të kërkimit <sup>4</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur	Po, ky program studimi ofron nxitjen dhe zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. Studentët e programit synohet të kenë një profil akademik unik që krijohet për

<sup>2</sup> Ky program studimi hapet në bazë të Urdhërit me nr. 302 të Ministrisë së Arsimit të datës 01/06/2018 (Ref. Nr. 7.2), si dhe në Akreditimi e Programit të Përbashkët, Master në Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja (PoSIG) Vjenë, 29 maj 2019 GZ: I/D-4/2019 (Ref. Nr. 54); Plani Strategjik 2015-2020, Vizioni, pika 9, fq. 3 (Ref. Nr. 3); EuroPS Dissemination Strategy 12102016 (Ref. Nr 4); PoSIG\_Marreveshja e programit (Ref. Nr. 7); Partnership Agreement University of Salzburg - UET (EN) (Ref. Nr. 7.2); Albanien UET SBG\_signed (Ref. Nr 7.3);

<sup>3</sup> Statuti UET, (Ref. Nr. 2).

<sup>4</sup> Plani Strategjik 2015-2020, Seksioni VI, fq. 7 (Ref. Nr. 3).

zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	shkak të fushave të specializimit, trupës ndërkombëtare të studentëve dhe pedagogëve dhe mobilitetit personal që lëviz midis universiteteve partnere të BE dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Për shkak të praktikës (që është e detyrueshme) studentët do të fitojnë ekspertizë specifike në lidhje me kushtet sociale, ekonomike dhe proceset politike në Ballkanin Perëndimor dhe proceset integruese të këtij rajoni. Në dekadën e tij të dytë, UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitar kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET <sup>5</sup> .
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e UET-it dhe partnerëve Ndërkombëtarë dhe përbën një arritje cilësore për objektivat akademike të Fakultetit të Shkencave, Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p> <p>Ky program studimi thekson kompetencën akademike në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe mundëson vazhdimin e një karriere të mëtejshme akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe formon specialistë të mirëfilltë të aftë për t’u përshtatur me kërkesat dinamike të tregut të punës.</p> <p>Nëpërmjet këtij programi studentët fitojnë:</p> <p>Njohuri:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✚ njohuri gjithëpërfshirëse për historinë dhe historinë debatet normative mbi legjitimitetin, pushtetin dhe demokracinë;</li> <li>✚ njohuri të teorive politike empirike në lidhje me pushtetin, demokracinë dhe lëvizjet bashkëkohore politike;</li> <li>✚ njohuri specifike mbi qasjet kritike për ideologjinë politike moderne.</li> </ul> <p>Kompetenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✚ aftësinë për të lexuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike qasjet teorike lidhur me çështjen e legjitimitetit, të pushtetit dhe të demokracisë;</li> <li>✚ aftësinë për të interpretuar realitetin politik në dritën e teorive normative empirike;</li> <li>✚ aftësinë për të analizuar lëvizjet dhe ideologjitë e fundit politike në bazë të koncepteve politike normative;</li> <li>✚ aftësinë për të kuptuar aspekte të ndryshme të kritikës sociale dhe për të aplikoni kritika të tilla për çështjet aktuale politike.</li> </ul> <p>Aftësitë:</p>

<sup>5</sup> Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020, Vizioni, pika 1.1 (Ref. Nr 3.1)

	<ul style="list-style-type: none"> <li>✚ Aftësia për të kryer hulumtime të pavarura dhe inovative në fushën e teorisë politike dhe historinë e ideve politike;</li> <li>✚ aftësinë për të ndjekur zhvillimet aktuale politike nga këndvështrimi e teorisë politike / politike empirike;</li> <li>✚ aftësinë për të shqyrtuar në mënyrë kritike ideologjitë politike dhe për të kuptuar në kontekstin e tyre social dhe historik;</li> <li>✚ Aftësia për të ofruar alternativa për filozofitë politike /teoritë.</li> </ul> <p>Për më tepër informacion shih, Kurrikula për Programin e Përbashkët Master në Shkencën Politike - Integrim dhe Qeverisje (PoSIG) (Versioni 2017) Miratuar në Bordin e Koordinatorëve të EuroPS në Lubjanë më 12 maj 2016.<sup>6</sup></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Zbatimi i kurrikulës së Masterit PoSig rregullohet në një Marrëveshje Bashkëpunimi (Partneriteti) e cila është nënshkruar nga Bordi i kordinatorve më 08-12 Maj, 2016 në Lubjanë. Kjo marrëveshje përfshin rregulloret për qeverisjen e programit dhe menaxhimin e cilësisë së saj. Gjithçka është përcaktuar në përputhje dhe zbatim të stretegjisë së UET <sup>7</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Po, Statuti dhe Plani Strategjik i institucionit, dhe Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të UET dhe demonstrojnë se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit <sup>8</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Po, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare janë dy nga drejtimit ku UET ofron programe studimi që prej themelimit të tij në vitin 2006. <sup>9</sup>

<sup>6</sup> PoSIG Marrëveshja e programit (Ref. Nr. 7)

<sup>7</sup> PoSIG Marrëveshja e programit (Ref. Nr. 7); Plani Strategjik 2015-2020 (Ref. Nr 3); EuroPS Dissemination Strategy 12102016 (Ref. Nr 4);

<sup>8</sup> Bazuar në Nenet 6, 10 pika 10.1 të Statutit të UET-it (Ref. Nr. 2), Strategjisë së Kërkimit Shkencor në Uet (2017-2020), Seksioni 3 Objektivat strategjike (Ref. 3.1), Plani Strategjik 2015-2020, seksioni prioritetet (Ref. Nr. 3);

<sup>9</sup> Plani Strategjik 2015-2020, Pika 3 e Objektiveve Strategjike (f. 8) (Ref. Nr 3); VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 (Ref. Nr. 54)

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Po, Masteri PoSig është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Ky program është hartuar në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Europian, pikërisht për t’iu përgjigjur interesave kombëtare dhe rajonale të vendeve të përfshira në projekt: Shqipëri, Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, Maqedoni, të cilët do të përfitojnë nga shkëmbimi i eksperiencës me partnerët perëndimorë si Austria dhe Sllovenia.<sup>10</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi I.3

**Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i përbashkët i studimit Master i shkencave PoSIG është një ndër projektet më ambicioze të këtij UET dhe Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara nënvizon se, programi ka një orientim të qëndrueshëm në rezultatet akademike dhe kompetencat e studentit dhe kërkon një motivim të lartë të studentëve për vendime autonome lidhur me profilin akademik që zhvillojnë brenda kurrikulës. Studentët zgjedhin dy nga pesë fushat e mëdha të specializimit (Teori Politike, Politikë e Krahasuar, Administrim Publik, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integrimi Europian) që ofron programi. Në kuadër të projektit të përpilimit të tezës finale studentët provojnë kompetencat e tyre në një projekt kërkimor të pavarur dhe të mbikëqyrur nga një pedagog nga Austria ose Sllovenia dhe një mbikëqyrës i dytë nga IAL-të partnere të Ballkanit Perëndimor. Të gjithë studentët ndjekin studimet e vitit të parë në Austri ose Slloveni, ku ndjekin kurset teorike të Masterit në dy module (nga pesë) si dhe kursin e Metodave të Kërkimit. Në vitin e dytë ata ndjekin studimet në një nga Universitetet partnere të Ballkanit Perëndimor për të përfunduar kurset dhe tezën e Masterit. Një pike e forte e kurrikulës sa i përket kërkimit shkencor është që studentët e kanë të detyrueshme të ndjekin lëndët e Metodave të Kërkimit dhe Metodave të Avancuara të Kërkimit në Salzburg, si edhe pjesa më e madhe e provimeve zhvillohet përmes punimeve shkencore nga</p>

<sup>10</sup> PoSIG\_Marrevshja e programit (Ref. Nr. 7); Partnership Agreement University of Salzburg - UET (EN) (Ref. Nr. 7.2); Albanien UET SBG\_signed (Ref. Nr 7.3)

	studentët. Punimet kalohen dhe në sistem e antiplagjjarizmit <sup>11</sup> .
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Masteri i përbashkët në Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja është produkt i projektit “Zhvillimi i kurrikulave për një master të përbashkët në shkenca politike”, të financuar nga Bashkimi Europian, Programi Erasmus+ (me numër reference: 561485-EPP-1-2015—1-AT-EPPKA2- CBHE-JP).<sup>12</sup> Në këtë kuptim, Komisioni Europian, që ka financuar projektin, e ka gjykuar me vend dhe të nevojshëm ndërtimin e një masteri të tillë.</p> <p>Alumni i këtij programi do të ketë një profil unik akademik që bazohet në fushat e specializimit, në trupën ndërkombëtare të studentëve dhe pedagogëve dhe mobilitetin ndërmjet partnerëve perëndimorë dhe atyre në Ballkanin Perëndimor. Një internship i detyrueshëm do t'u ofrojë studentëve përvojë praktike në një mjedis organizativ. Në këtë kontekst, alumni do të fitojnë ekspertizë specifike në kushtet e proceseve sociale, ekonomike dhe politike në Ballkanin Perëndimor.</p> <p>Kurrikula e masterit nuk mbulon vetëm aspektet më të rëndësishme politikëbërëse të komunitetit, por edhe sfidat me të cilat entitete të tilla mund të përballen si rrjedhojë e natyrës së tyre të ndryshueshme në kontekstin integruar dhe qeverisës, gjë që i shërben më së miri aftësimin të studentit si një profesionist i cili përfiton aftësim, kompetencë dhe njohuri të domosdoshme në proceset inegruese dhe qeverisëse<sup>13</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara nënvizon se kurrikula e PoSig-it është një mundësi për të diskutuar zhvillimet e mëtejshme të standardeve të mësimdhënies të kurrikulës së Shkencave Politike në Evropë. Bazuar në nivelin e EQF 7 (Përshkrimi i ciklit të dytë në Kornizën për Kualifikimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë të miratuar nga ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në takimin e tyre në Bergen në maj të vitit 2005 në kuadër të procesit të Bolonjës korrespondon me rezultatet e mësimin për nivelin 7 të EQF), të diplomuarit e PoSig përgatiten për punë të kualifikuar në fusha dhe nivele të ndryshme të sistemeve politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Në hartimin e këtij masteri jemi përqendruar në sugjerimet strategjike të dhëna nga studimet e Komisionit Europian i cili është edhe iniciatori i shtimit të fondeve për zhvillimin e programeve të arsimit të lartë siç janë projektet e Erasmus +, në këtë kontekst masteri vë në qendër studentin duke diversifikuar mundësinë e shkollimit të tij pasi studenti zgjedh në bazë të moduleve</p>

<sup>11</sup> PoSIG\_Marrevshja e programit (Ref. Nr. 7); PoSiGi\_curr-political-science\_final\_2017 (Ref. Nr 14); Plani mësimor i programit (PoSIG) (Ref. Nr 14.1);

<sup>12</sup> <http://euro-ps.org/the-project/>

<sup>13</sup> PoSIG Studim Tregu (Ref 16)



	të ndryshme specializimin specifik që do të marrë në politikat integruese, duke i krijuar në këtë mënyrë mundësi specifike dhe konkrete në adresimin e dijeve të tij/saj <sup>14</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Programi i Përbashkët Msc. në Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja reflekton kontributin dhe përvojën e gjithë universiteteve partnere (9 IAL gjithsej) që punuan së bashku për hartimin e kurrikulës. Puna e bërë në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Europian, dhe shkëmbimi i eksperiencës mes universiteteve partnere, ka garantuar përafrimin e këtij program me programe të tjera ndërkombëtare, çka mundëson transferimin e lehtë të studimeve. Programi i përbashkët, PoSIG, bazohet në standardet ndërkombëtare dhe standardet e mësimdhënies së shkencave politike në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe ciklit të dytë të QF-EHEA (Qualifications Frameworks in the European Higher Education Area). Secili nga universitetet partnere është angazhuar në zhvillimin e lëndëve të kurrikulës ku ka edhe ekspertizë më të madhe <sup>15</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	Programi i Përbashkët u zhvillua si pjesë e Projektit Erasmus+ KA2 për Ngritjen e Kapaciteteve, Projekti 561485 - 2015-2017, “ <b>Curriculum Development joint European Political Science MA (euroPS)</b> ”. Si kurrikul e hartuar në përmbushje të detyrimeve të një projekti të financuar nga Bashkimi Europian, ky program përmbush të gjithë objektivat e përcaktuara nga direktivat e BE-së, dhe ka shfrytëzuar përvojën më të mirë të universiteteve partnere, të cilët kanë punuar bashkarisht për mbylljen me sukses të projektit <sup>16</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Nëpërmjet projekteve të tezës së masterit, studentët inkurajohen të kryejnë kërkime inovative që lidhen me zhvillimin social, ekonomik dhe politik të rajonit. Të diplomuarit do të jenë në gjendje të kontribuojnë në proceset që lidhen me evropianizimin, dhe debatet politike që i rrethojnë ato.  Fushat tipike profesionale të të diplomuarve të Programit të Përbashkët Master në Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja janë:

<sup>14</sup> Në aplikimin e projektit për zhvillimin e kurrikulës së masterit PoSIG është parashtruar qartë nevoja që vendet si Shqipëri, Maqedonia apo Bosnja dhe Hercegovina kanë sa i takon përmirësimit të kurrikulës në shkenca politike, ndërkombëtarizimit të programeve të studimit në shkenca politike dhe ndërlihdja e studimeve me tregun e punës – gjë të cilën e realizojnë përmes dhënies së vlerës së shtuar diplomës në shkenca politike. Ngritja e programit master në tërësi është bazuar në ekspertizën e vendeve evropiane perëndimore duke sjellë si rrjedhojë programin master më të konkureshëm në vend madje edhe në rajon duke e bërë të domosdoshëm arritjen e implementimit të tij si një program sa i shumëllojshëm aq edhe specifik në adresimin e zgjidhjes së problemeve dhe vendimmartjes politike nëpërmjet metodave më të avancuara të njohura në studimet e shkencave politike, gjë që i mungon tregut shqiptar dhe si rrjedhojë e bënë shumë të nevojshëm madje të domosdoshëm implementimin e tij. PoSiG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14);

<sup>15</sup> <http://euro-ps.org/curriculum/>

<sup>16</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14)

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- punësimi në nivel lokal dhe kombëtar në administratën publike, parlamentet dhe partitë politike, organizatat joqeveritare, grupet e interesit dhe sindikatat, sektori i biznesit, mediat dhe marrëdhëniet me publikun;</li> <li>- punësimi në organizatat ndërkombëtare, shërbimet e jashtme (karriera në diplomaci), në institucionet e Bashkimit Evropian dhe në organizatat jofitimprurëse, organizatat jofitimprurëse, agjencitë zhvillimore dhe OJQ-të ndërkombëtare;</li> <li>- punësimi në fushën e edukimit qytetar dhe politik (fondacione, akademi, institute arsimore, think tank, etj.);</li> <li>- Karriera akademike (PhD, mësimdhënie dhe kërkime në universitete dhe institucionet kërkimore).</li> </ul> <p>Institucionet pjesëmarrëse i mbështesin studentët e tyre në identifikimin e punësimit për praktikën dhe zhvillimin e një rrjeti alumni PoSIG dhe aktiviteteve të mediave sociale.</p> <p>Sipas ngarkesës së punës së ECTS prej 6 ECTS, praktika duhet të përfaqësojë një përvojë pune 4-javor të rregullt pune. Kjo ngarkesë mund të bëhet me kontratë me orar të plotë, ose me një kontratë praktike me kohë të pjeshme me një kohëzgjatje të barabartë të vendosjes.</p> <p>Stazhi duhet të lejojë një reflektim mbi përvojën e studimit të PoSIG, por gjithashtu mund të përdoret për të zhvilluar dhe kualifikuar interesat e hulumtimit për projektin e tezës së studentit. Partnerët e Projektit të EuroPS-ë mbështesin studentët në praktikën e tyre duke ofruar një listë të adresave të kontaktit për mbështetjen financiare (kombëtare ose të tjera, të tilla si grantet e Erasmus+ grante për stazhe)<sup>17</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Ky program ka karakter ndërkombëtar dhe elemente e mësimdhënies, moduleve, lëndëve si dhe i gjithë programi ofrohet në gjuhën angleze. UET ka angazhim optimal për të realizuar orët aplikative në lëndët përkatëse. Gjithashtu dëshmon angazhim optimal për përmbushjen e objektivave të programit të studimit PoSIG.</p> <p>Në kuadër të projektit të përpilimit të tezës finale studentët provojnë kompetencat e tyre në një projekt kërkimor të pavarur dhe të mbikëqyrur nga një pedagog nga Austria ose Sllovenia dhe një mbikëqyrës i dytë nga IAL-të E Ballkanit Perëndimor. Të gjithë studentët ndjekin studimet e vitit të parë në Austri ose Slloveni, ku ndjekin kurset teorike të Masterit në dy module (nga pesë) si dhe kursin e Metodave të Kërkimit. Në vitin e dytë ata marrin pjesë në një Universitet partner të Ballkanit Perëndimor për të përfunduar kurset dhe tezën e Masterit<sup>18</sup>.</p>

<sup>17</sup> PoSIG\_Marrevshja e programit (Ref. Nr 7); PoSiG curr-political-science final\_2017 (Ref. Nr 14); dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr 12); PoSIG Institucionet ne funksionet te realizimit te praktikës mesimore (Ref. Nr 32)

<sup>18</sup> PoSIG Marrevshja e programit (Ref. Nr 7);

<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.	Po, institucioni nëpërmjet personelit të Sekretarisë Mësimore përgatit, ruan dhe arkivon dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar në UET si dhe çdo material tjetër që ka lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të programit PoSIG. <sup>19</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi I.4

#### Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare ku përfshihet edhe programi i studimit ka një eksperiencë mbi 10 vite. <sup>20</sup> Cilësia e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të UET, kombinuar me angazhimin e profesorëve nga universitetet perëndimore të Salzburgut dhe Lubllanës, janë garantojnë përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit <sup>21</sup> . Stafi akademik është i kualifikuar dhe i përshtatshëm për ofrimin e programeve në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënies ndërkombëtare. <sup>22</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit si dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e ofruara nga Departamenti. <sup>23</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	UET ka institucionalizuar dhe përmirësuar vlerësimin e punës kërkimore shkencore të anëtarëve të personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe i Marrëdhënies Ndërkombëtare, veçanërisht personelit të Departamentit ShSA. Kërkimi shkencor në DSSH është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Stafi i departamentit është i kualifikuar për mbulimin e fushës së programit të studimit për 4 nga 5 fushat kryesore që ai mbulon (Teori politike, Politikë e Krahasuar, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integrim European), ndërkohë që fusha Politika publike

<sup>19</sup> Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr 9)

<sup>20</sup> VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, Për licencimin e Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr. 54)

<sup>21</sup> Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse (Ref. Nr. 23)

<sup>22</sup> Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit (Ref. Nr. 24)

<sup>23</sup> Të dhëna për numrin e programeve të ofruara nga njësi përgjegjëse (Ref. Nr. 26)

	dhe Administrim, mbulohet në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut. Kjo sa i përket ekspertizës që UET mbulon, ndërkohë që për mënyrën si është ndërtuar kurrikula e programit, lëndët e vitit të parë të studimeve ndiqen në universitetet partnere perëndimore, të cilët kanë gjithashtu kapacitete edhe ekspertizë edhe më të thelluar për zhvillimin lëndëve të programit në nivelin e kërkuar. <sup>24</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit. UET-i siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre <sup>25</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Programi Master i përbashkët në Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja vjen si produkt i një bashkëpunimi mes nëntë institucioneve partnere, në fushën e shkencave politike. Partnerët kanë zhvilluar që në vitin 2015 projekte dhe aktivitete të përbashkëta me synim harmonizimin e zhvillimin e kurrikulës akademike të shkencave politike. Projekti dhe masteri në fjalë janë në përputhje me prioritetet që Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Zyra Erasmus+ në Shqipëri kanë përcaktuar për programin Erasmus+ dhe qartësisht një nga disiplinat e përcaktuara si prioritet për zhvillim kurrikulash është edhe Shkenca Politike. E njëjta vlen për vendet e rajonit që janë të përfshira në konsortiumin e masterit. Universitetet partnere kanë përzgjedhur stafet e tyre akademike më të specializuara në fushat e studimit të rajonalizmit , integritit dhe qeverisjes. Kjo ekspertizë do t'i mundësojë studentit njohjen, aftësimin dhe përvetësimin e politikave krahasimore të rajonit duke

<sup>24</sup> CV-të e personelit akademik (Ref. Nr 20)

<sup>25</sup> Rregullore e UET, Neni 16, 17, 18, 21, 22 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.IV-F. V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6)

	nxjerr në pah praktikat më të suksesshme dhe mundësia e adaptimit të tyre në vende dhe çështje specifike <sup>26</sup> .
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Projekti për Ndërtimin e Kapaciteteve Erasmus+ për ngritjen e cilësisë së Programit Master PoSig disponon një bazë të dhënash të marrëveshjeve të palëve të interesuara në EuroPS (561485-EPP-1-2015-1-AT-EPPKA2-CBHE-JP).</p> <p>UET aktualisht ka nënshkruan 25 marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit si dhe 12 syresh janë në process nëshkrimi.</p> <p>Programi Master i Përbashkët në Shkenca Politike – Integrimi dhe Qeverisja në Shqipëri, ofrohet si nga Universiteti European i Tiranës ashtu edhe nga Universiteti i Tiranës, të cilët janë partnerë në të njëjtën iniciativë. Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit (Neni 2), është parashikuar që studentët e interesuar për të ndjekur masterin e përbashkët, në vitin e parë akademik 2017 – 2018, do të kenë mundësi të regjistrohen në Universitetin e Salzburgut. Vetëm në vitin e dytë akademik, 2018 – 2019, ata mund të ndjekin studimet në një nga IAL-të e tjera të përfshira në konsorcium. Modalitetet dhe detajet e zhvillimit të programit të përbashkët gjenden në Marrëveshjen e Bashkëpunimit, e cila ka të integruar dhe rregulloren mësimore të programit të studimit. E njëjta logjikë ndiqet dhe në vitet në vijim, çka nënkupton se vitin e parë të studimeve, studentët e zhvillojnë në një nga universitetet partnere dhe vetëm në vitin e dytë ata mund të zgjedhin të ndjekin studimet në njërin nga universitetet në Shqipëri, në UET ose në UT. Pra, UET dhe UT marrin pjesë në zhvillimin e një pjese të kurrikulës së programit, pasi në çdo rast, studenti vitin e parë të studimeve do e ndjekë në një nga universitetet partnere, anëtare të Bashkimit European<sup>27</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit PoSIG ka për synim përfshirjen e studentëve ndërkombëtarë jo vetëm shqiptarë, ky master i mundësuar nga nëntë universitete të ndryshme kërkon studim më të gjerë tregu, në nivel rajonal dhe si rrjedhojë për hapjen dhe ideimin kurriular të tij i jemi referuar studimeve të Bashkimit European dhe të institucioneve zyrtare të tyre të cilat specifikojnë nevojën për investime në studimet e integritit të rajonit pasi edhe një pjesë e vendeve aderuese duhet të përgatisin burime njerëzore të afta për të përthithur politikat specifike rajonale dhe për të njohur dhe për të qenë kompetent në mënyrën e funksionimit të Bashkimit European.</p>

<sup>26</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit, (Ref. Nr. 7); Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit (Ref. Nr. 34)

<sup>27</sup> PoSIG Marreveshja e programit (Ref. Nr. 7); EuroPS\_Dissemination Strategy 12102016 (Ref. Nr. 4); EuroPS Consolidated Stakeholders DB 28112016 (Ref. Nr 34.1)

	Në hartimin e këtij masteri jemi përqendruar në sugjerimet strategjike të dhëna nga studimet e Komisionit Europian i cili është edhe iniciatori i shtimit të fondeve për zhvillimin e programeve të arsimit të lartë siç janë projektet e Erasmus+, në këtë kontekst masteri vë në qendër studentin duke diversifikuar mundësinë e shkollimit të tij pasi studenti zgjedh në bazë të moduleve të ndryshme specializimin specifik që do të marrë në politikat integruese, duke i krijuar në këtë mënyrë mundësi specifike dhe konkrete në adresimin e dijeve të tij/saj <sup>28</sup> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, pranë Universitetin Europian të Tiranës në bashkëpunim me Universtietin e Tiranës, Universitetin e Salzburgut, Universitet e Lubjanës, Universitetin “Ss. Cyril and Methodius”, Shkup, Kolegjin Fama, Kosove, Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë, Kosovë, Universitetin e Sarajeves, Shkolla e Sarajeves per Shkencë dhe Teknologji dhe Universitetin e Tiranës. Si dhe bazuar në Nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Statutit UET-it Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve <sup>29</sup> .			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Po, në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit <sup>30</sup> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Në dekadën e tij të dytë, UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si <b>qendër e prodhimit të dijes</b> në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësim-dhënie, në një institucion elitar kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET.

<sup>28</sup> PoSIG Marreveshja e programit, (Ref. Nr 7); EuroPS Dissemination Strategy 12102016; (Ref. Nr 4)

<sup>29</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit (Ref. Nr 7) EuroPS\_Dissemination\_Strategy\_12102016; (Ref. Nr 4) Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28); EuroPS Consolidated Stakeholders DB 28112016 (Ref. Nr 34.1)

<sup>30</sup> Raport rreth zbatimit të projektit (Ref. Nr. 38)

	<p>UET u ofron pedagogëve mundësinë për të publikuar në revistën ndërkombëtare shkencore POLIS dhe për të referuar në konferencën ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”. Aktualisht janë rritur kërkesat në drejtim të cilësisë së punimeve duke kërkuar publikimeve në revista me faktorë impakti mundësisht Thomson Reuters/Clarivate<sup>31</sup> dhe për të nxitur këtë UET ka ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikujt.<sup>32</sup></p> <p>Gjithashtu, studentët e programit, nxiten nga pedagogët e tyre të botojnë punimet e tyre në revistën shkencore “Polis”, ose të referojnë në konferencën ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”.</p>				
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>UET ka hartuar Strategjinë e kërkimit shkencor në UET (2017-2020), i cili shërben si dokument rregullator për kërkimin shkencor. Kjo strategji detajon objektivat dhe instrumentat që do të përdorë UET për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor.</p> <p>Në organikën e UET, është përcaktuar edhe pozicioni i Zv. Rektorit për kërkimin shkencor, që kujdeset edhe për pjesën e kërkimit shkencor dhe studimet e ciklit të tretë në UET.</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Çdo dy vjet në UET, realizohet follow up me stafin akademik mbi publikimet dhe aktivitetin e tyre shkencor<sup>33</sup>. Gjithashtu, nëpërmjet financimeve që UET ofron, nxit promovimin e kryerjes së kërkimit shkencor. Promovimi i këtyre rezultateve realizohet gjatë mbledhjeve të ndryshme, si psh., në Asamblenë e personelit akademik, gjatë mbledhjeve të departamentit, apo edhe publikimeve nga Shtëpia Botuese UET Press, Gazeta Liberale, etj.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>UET ka të parashikuar në Kodin e Etikës së institucionit praktikën e mira që duhet të ndjekë çdo anëtar i komunitetit UET, qofshin këta anëtarë të personelit apo student, për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si edhe praktikën e mira në veprimtarinë kërkimore e botuese.<sup>34</sup></p> <p>Gjithashtu, instalimi i sistemit të antiplagjiaturës Turnitin Ephorus, ndihmon për të kontrolluar punimet e studentëve, pavarësisht kufizimeve që ka.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Po, Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.<sup>35</sup></p>				
	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: #f4a460;">Nuk përmbushet</td> <td style="background-color: #ff0000; color: white;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: #ffcc00;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #92d050;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

<sup>31</sup> Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020 (Ref.Nr. 3.1)

<sup>32</sup> Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020, pika 14 (Ref.Nr. 3.1)

<sup>33</sup> Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020, pika 5.2 (Ref.Nr. 3.1); Format i G.1.12.1 Formular për vetvlerësimin e performancës së personelit akademik (Ref. nr. 41)

<sup>34</sup> Dokumenti A.II. Kodi i Etikës, pika A.II.7.1 dhe A.II.7.2 (Ref. Nr. 56)

<sup>35</sup> Bazuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2017-2020, përkatësisht, Nenet 1, pika 1.2, Neni 3 pikat 3.3 dhe 3.4, Neni 7 pikat 7.3, 7.4. Neni 8 pika 8.2, 8.4. Neni 12 pikat 12.2.2, 12.2.4, Neni 14 pika 14.2, 14.3. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor (Ref. Nr 3.1)

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit është i organizuar sipas legjisalcionit shqiptar të arsimit për progamet master dhe kartës së Bolonjës të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Programi i studimit konsiston në 10 kurse të detyrueshme, një intership, kurse shtesë dhe një punim diplome Master, me një total prej 120 ECTS.</p> <p><b>Modulet e detyrueshme 2 nga 5 ECTS (36)</b></p> <p>Teoritë politike 18</p> <p>Politika e Krahasuar 18</p> <p>Administrata publike 18</p> <p>Marrëdhënie ndërkombëtare 18</p> <p>Integrimi European 18</p> <p><b>Kurset e detyrueshme ECTS (24)</b></p> <p>Intership 6</p> <p>Kursi i metodave I 6</p> <p>Kursi i metodave II 6</p> <p>Seminaret për punimin e diplomës 6</p> <p><b>Kurse e detyrueshme me zgjedhje 1 nga 2 ECTS (6)</b></p> <p>Metoda të avancuara në Shkenca Politike 6</p> <p>Kurse të aplikuara 6</p> <p><b>Kurse shtesë ECTS (24)</b></p> <p><b>Mbrojtja e punimit të diplomës ECTS (30)</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	<p>Profesionet tipike që mund të ushtrohen mbas mbarimit të programit master në ‘Master i përbashkët në Shkenca Politike- Integrimi dhe Qeverisja’ (POSIG), janë si më poshtë:</p> <p>-Punojës i administratës publike në nivel lokal dhe qendror, i parlamentit dhe partive politike, organizata jo qeveritare, grupet e interesit dhe organizatat e biznesit, media dhe marrëdhënie me publikun.</p> <p>- Punojës në organizatat ndërkombëtare, shërbimet e huaja (diplomaci), në institucionet e Bashkimit European, organizata ndërkombëtare fitimprurëse ose jo fitimprurëse,</p>



	<p>-Punojës në fusëhn e edukimit civil dhe politik (fondacione, akademi, institute të edukimit)</p> <p>-Karrierë akademike (lektor, kërkues shkencor etj).<sup>36</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Mbas mbarimit të programit Master studentët pajisen me një sërë njohurish dhe kompetencash:</p> <p>-Njohuri të përgjithshme për teoritë e shkencave politike, konceptet politike, aktorët, institucionet, proceset, normat, politikat qëndrore të fushës.</p> <p>- Aftësinë për të kuptuar, aksesuar dhe aplikuar kërkimet në shkencat sociale me standarte të larta metodologjike në module të tjera.</p> <p>-Aftësinë për të analizuar probleme politike dhe shoqërore, bazuar në konceptet dhe teoritë e shkencave sociale.</p> <p>-Aftësitë dhe njohuritë për të menduar dhe për të aplikuar në mënyrë kritike instrumentat metodologjik të analizës empirike në fushën e kërkimit të shkencave politike, duke përfshirë përdorimin e softëereve statistikor, dhe planifikimin e zhvillimin e kërkimeve shkencore individuale.</p> <p>-Aftësinë për të punuar në grup, edhe inter-disiplinare për të zhvilluar kërkime shkencore.</p> <p>-Aftësinë për të prezantuar kërkime shkencore komplekse përpara një audience.<sup>37</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i Masterit zhvillon njohuritë dhe aftësitë në fushën akademike dhe profesionale për zgjidhjen e problemeve komplekse e mëposhtme:</p> <p>-Aftësinë për të kuptuar nivele të larta të literaturës të shkencave sociale dhe politike, dhe për ti analizuar ato në mënyrë kritike duke i përdorur edhe në disiplinina të ngjashme si ekonomia, e drejta, sociologjia, historia.</p> <p>-Aftësia për të debatuar dhe krahasuar pozicionet individuale për çështje të ndryshme dhe për ti modifikuar këto qëndrime nëse është e nevojshme.</p> <p>-Aftësia për t’i kuptuar problemet politike dhe shoqërore, për të zhvilluar strategji praktike për zgjidhje të problemeve dhe për ti paraqitur ato publikut.</p> <p>-Aftësia për të lidhur shkencën me politikën praktike</p> <p>-Aftësia për të qenë pjesëmarrës në politikë në bazë të studimeve shkencore.<sup>38</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Msc. Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja ofrohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015, Neni 80, sipas të cilit:</p> <p>- Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.</p> <p>- Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.</p>

<sup>36</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14)

<sup>37</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14)

<sup>38</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14)

	- Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. <sup>39</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Ky program studimi e ka të përcaktuar qartë veprimtarinë formuese të tij, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Kjo është e shprehur edhe në Planin Mësimor të programit të studimit. <sup>40</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Kreditet për realizimin e diplomës janë 30 ECTS të parashikuara nga kurrikula e Masterit. Punimi i diplomës është një projekt kërkimor individual, i cili përcakton fushën e specializimit të studentit. Punimi i diplomës monitorohet nga dy supervisor të specializuar në fushën përkatëse. Tema e punimit të diplomës duhet të lidhet me një nga dy modulet e detyrueshme. Studenti mund ta zgjedhi vetë temën e diplomës, ose të zgjedhi një nga temat e propozuara nga supervisorët. Tema duhet të ketë nga 25.000 deri në 30.000 fjalë. Studentët ndjekin seminarët e punimit të diplomës, me qëllim për të ndihmuar studentët në zhvillimin e saj. Procesi i supervizimit pasqyrohet në platformën elektronike ePortofolio të çdo studenti. Ky dokument përmban: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një ekspozim me pyetjet kërkimore dhe metodologjinë e përdorur</li> <li>- Vlerësimin e supervisorëve për këtë ekspozim</li> <li>- Punimin e Diplomës</li> <li>- Vlerësimin e dy supervisorëve për punimin e diplomës.<sup>41</sup></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Qeverisje dhe Integrim. Njësia bazë përmbush të gjitha detyrime të parashikuara në lgjislacionin për arsimin e lartë të Shqipërisë, si nga ana e kapaciteteve të burimeve njëzore, po ashtu edhe atyre logjistike dhe shkencore.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, edhe Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, përgjegjës për programin e studimit MSc. Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja” përmbushin

<sup>39</sup> Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë,” neni 80 (Ref. Nr. 53)

<sup>40</sup> Plani mësimor i programit PoSIG (Ref. Nr. 14.1)

<sup>41</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017, fq. 8-9 (Ref. Nr. 14)

	detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti është krijuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 dhe riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 526 datë 04.09.2018. UET është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, dhe pas riorganizimit me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2019. <sup>42</sup> Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit, dhe është ngritur me Urdhër të Rektorit të UET-it, Nr. 03, datë 04/03/2019.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Si njësia kryesore dhe ajo bazë ku ofrohet programi i studimit përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Departamenti i zotëron kapacitetet e nevojshme të personelit akademik për realizimin e këtij programi studimi. Personeli akademik I angazhuar me me kohë të plotë dhe të pjesshme ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e procesit mësimor. Personeli i departamentit për vitin akademik 2018-2019 është përbërë nga 15 anëtarë të angazhuar me kohë të plotë, nga të cilët 2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. Dr., 7 me gradën shkencore Dr./PhD, 1 në proces doktore dhe 3 Msc; si dhe 3 anëtarë të angazhuar me kohë të pjesshme, nga të cilët 1 Prof. Dr. dhe 2 asistent lektorë me Msc. <sup>43</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësoj si Kriteri 2. Shih më sipër.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Në ciklin e dytë të studimeve, studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/kompani i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës i departamentit, i caktuar në rolin e Këshilluesit të karrierës. Të gjitha procedurat janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit. <sup>44</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Koordinatori i programit të studimit, Prof. Asoc. Dr. Ervis Iljazaj është caktuar me vendim Nr. 93, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare. Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET. <sup>45</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. Në të njëjtën kohë ky kordinator mban përgjegjësi për kontrollin e cdo elementi që lidhet me cilësinë e mësimdhënies (ku

<sup>42</sup> VKM 636, datë 20.09.2016 dhe vendimet e Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional (Ref. Nr. 54)

<sup>43</sup> Te dhena tabelore për personelin e njësise kryesore dhe baze (Ref. Nr. 23)

<sup>44</sup> Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr.32.1)

<sup>45</sup> Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit (Ref. Nr. 36); Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit (Ref. Nr. 6)

	përfshihen, syllabuset, tekstet, metodologjia, kontrolli i tezave, i eseve etj). Çdo gjë perpara se te kaloj në implementim kalon në dorën e kordinatorit përgjegjës të programit. Kriteri plotësohet.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.3

**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore (Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare), edhe njësia bazë (Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara) përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë "PoSIG", disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve, shumica e të cilave përfshihen edhe në këtë raport, ose janë në dosjen e dokumenteve që i janë bashkangjitur këtij raporti.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Po. Programi i studimit ka 120 kredite ECTS, të cilat ndahen në kurse të detyrueshme, module, praktikë, kurse shtesë, si dhe punimin e diplomës për marrjen e diplomës Master.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Të gjitha lëndët dhe modulet e parashikuara në kurrikulën e programit janë të ndara me kredite sipas sistemit europain. Këto të dhëna detajohen edhe në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit. <sup>46</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Po. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mesimore, orët e leksioneve në auditor dhe jashtë tij, si dhe të gjitha informacionet për frekuentimin e programit dhe vlerësimit të dijeve. <sup>47</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Studentët selektohen dhe regjistrohen nga Komisioni i Bordit të Kordinatorëve në bazë të kriterëve të gjithëpranuara, dhe të bëra publike paraprakisht, si më poshtë: -Performacën akademike të nivelit të studimit të mëparshëm; -Motivimit -Letrat e rekomandimit -Rezultatet e e intervistës personale -Niveli i gjuhës angleze.

<sup>46</sup> PoSIG\_Marrëveshja e programit (Ref. Nr. 7)

<sup>47</sup> Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1); PoSIG\_Marrëveshja e programit (Ref. Nr. 7)

	Të gjitha këto kritere vlerësohen me pikët përkatëse nga Koimisioni, duke zgjedhur kështu studentët që fitojnë pikët më të shumta sipas renditjes. Gjithashtu programi i studimit Master përmban të gjitha informacionet e nevojshme për të gjithë studentët që kërkojnë të transferohen, të cilat janë në bazë të kartës europiane të Bolonjës. <sup>48</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Po. Çdo modul dhe lëndë ka përshkrimin e saj specifik dhe i korrespondon një numri të caktuar orësh leksionesh dhe praktikash, të cilat kanë numrin përkthës të krediteve. Të gjithë komponentët formues të programit janë të mirëpërcaktuara me detaje në përputhje me formatet e miratuara nga përgjegjësit e programit Master. Çdo lëndë dhe modul ka syllabusin e saj që është i përshkruar në mënyrë të detajuar duke shpjeguar orët e leksioneve, përmbajtjen e lëndëve, literaturën e detyrueshme dhe atë më zgjedhje, kompetencat dhe njohuritë që përfitohen nga to, si dhe cdo temë të cdo leksioni të vecantë të përshkruar me detaje.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Departamenti është përgjegjës për përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve, për të cilat UET jep kontributin e tij në këtë program studimi. Rishikimi bëhet në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme. Syllabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. <sup>49</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/ “Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Po, ngarkesa e studimeve është ndërtuar sipas legjisllacionit evropian dhe shqiptar të arsimit. Studimet në këtë program studimi ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, dhe realizohen me 120 kredite.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Kurrikula e programit Master PoSIG është ndërtuar duke patur parasysh thellimin e njohurive për të ndjekur programe të mëtejshme të studimeve, por edhe për tu përballur me tregun e punës. Në këtë kurrikulë e gjithë veprimtaria akademike fokusohet te marrja e njohurive dhe kompetenca specifike në metodologji, në teorinë e

<sup>48</sup> PoSIG\_Marrëveshja e programit, Shtojca B, fq. 41 (Ref. Nr. 7)

<sup>49</sup> Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6)

	shkencave politike dhe sociale, por edhe njohuri praktike për të zgjidhur probleme të komplikuar.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar më konkretisht edhe në Planin Mësimor (bashkangjitur këtij raporti) të programit të studimit “PoSIG”, janë ndërtuar për të mundësuar më së miri arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional të studentëve të diplomuar.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë, sikundër specifikohen në Planin Mësimor, janë në përputhje me profilin e programit Master ku ai zhvillohet, si edhe në përputhje me programet të ngjashme dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare që zhvillohen nëpër universitetet Perëndimore.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë, sikundër specifikohen në Planin Mësimor, janë në përputhje me profilin e programit Master ku ai zhvillohet, si edhe në përputhje me programet të ngjashme dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare që zhvillohen nëpër universitetet Perëndimore.
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në programin e studimit “PoSIG” janë bërë në përputhje me synimin e arritjes së objektivave formues. Gjithashtu, ky program studimi, ashtu sikundër edhe çdo program studimi tjetër në UET, mundëson transferim të studimeve dhe mobilitet siç parashikohet në Nenit 37 të Statutit UET, në nenet 35 dhe 42 të Rregullores së UET.
<b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Masteri i përbashkët në Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja, zhvillohet në gjuhën angleze. E gjithë litaratura është bazuar te autorët më të njohur ndërkombëtarë, si ajo e detyrueshme, si ajo ndihmëse. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, kërkohet që literatura bazë dhe e rekomanduar e përfshirë në Syllabus të datojë jo më e vjetër se 5 (pesë) viteve të fundit dhe të jenë të botuara nga pesë shtëpitë botuese më të njohura në botë si: Oxford, Pearson, Sage, Cambridge, McGraw-Hill, etj. <sup>50</sup> Çdo shmangie nga ky standard nevojitet të argumentohet me shkrim nga pedagogu i lëndës dhe të pranohet nga drejtuesi i departamentit përpara miratimit të syllabusit.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Përmbajtja e programeve të studimit, për nga vetë mënyra dhe kriteret specifike si ato ndërtohen, monitorohen dhe kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative e universitetit... e cila vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit ne fuqi14), garantojnë e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për këtë program studimi në ciklin e dytë.

<sup>50</sup> Dokumenti A.III, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literatures, pika A.III.12.2. (Ref. Nr. 39)

<b>Kriteri 8.</b> Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të ciklit të tretë, doktoraturës. Gjithashtu, pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve, studentët mund të punësohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <sup>51</sup>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Departamenti realizon dy herë në vit mbledhje me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës dhe merr në konsideratë mendimet, propozimet dhe konsultohet me ta, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.			
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Përbajtja e programit të studimit Master i Shkencave “PoSIG” mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, dhe është hartuar/përmirësuar që të jetë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe që të garantojë mundësitë e punësimit të diplomuarve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Nenet 42, 43, 44, 45 të Statutit, si edhe Neni 10 i Rregullores së UET, në mënyrë eksplicite përcaktojnë të gjitha kriteret, kategoritë dhe procedurat për rekrutimin dhe përmbushjen e detyrimeve për personelin akademik që angazhohet në realizimin e programeve të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Personeli akademik më kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit plotëson të gjitha kriteret konform kërkesave ligjore në fuqi dhe ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e procesit mësimor. Neni 42, pika 3 i Statutit UET specifikon se “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës” (Statuti i UET, Fq 25)
<b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me	Përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertiza akademike dhe kërkimore të pedagogut, përvojës në fushën e mësimdhënies. Si rregull, anëtari më i kualifikuar i

<sup>51</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017, fq. 3-4 (Ref. Nr. 14)

programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	personelit akademik mbulon lëndën/lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit përkatës. <sup>52</sup>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Po. Studentët ndiqen në çdo hap nga personeli pedagogjik për punimin e diplomës, të cilët janë dy supervizorë që kanë njohuri specifike akademike në fushën ku studenti zhvillon temën e diplomës. Ky mentorim bëhet që nga faza e ideimit të punimit të diplomës e deri te përfundimi dhe mbrojtja e saj. Gjithashtu për intershipet që parashikohen në kurrikul, personeli mban marrëdhëniet me institucionet ku zhvillohen ato, si dhe ndihmon studentët në të gjitha procedurat. <sup>53</sup>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Për këtë program nuk parashikohen orë laboratorike, por në nivel fakulteti dhe institucioni ka zyra përgjegjëse, që merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore.		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

## Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve. Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti). Institucioni programon politika dhe ndërmer masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. <sup>54</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe	UET synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit si dhe sigurimin e përfshirjes së studentëve më të dalluar të departamenteve apo fakulteteve përkatëse në kërkimin shkencor, botimet

<sup>52</sup> Dokumenti G.II. Mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore (Ref. nr. 11); CV-të e pedagogëve (Ref. Nr. 20)

<sup>53</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit (Ref. Nr. 7); Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12); Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1)

<sup>54</sup> Statuti UET, Neni 30 pika 4, (Ref. Nr. 2)



reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	akademike, revistat shkencore, konferencat dhe ëorkshopet, aktivitetin kërkimor-shkencor, etj. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë në qendër të Planit Strategjik 2015-2020, pjesa Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore, pika 1. Gjithashtu UET zhvillon mbledhje me Bordin e Tregut të Punës, pjesë e të cilit janë ish studentë të UET, tashmë pjesë e tregut të punës të cilët shprehin mendimet e tyre për përmirësimin e programeve apo futjen e lëndëve të reja në programe të caktuara.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Zyra e Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në Europë e më gjerë.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Në rastet kur lind nevoja për organizimin e programeve të posaçme, të cilat kanë fokus zhvillimin dhe përmirësimin e institucioneve, UET është gjithmonë i hapur për t'i përmbushur këto nevoja duke përshtatur dhe riorganizuar programe, gjithmonë konform respektimit dhe zbatimit të ligjit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit PoSIG, është një program I përbashkët në shkenca politike ku marrin pjesë shumë universitete europiane dhe Ballkanike. Programi është ndërtuar në bazë të prioritetëve dhe objektiva europian të arsimit, të cilat bazohet te marrja e njohurive dhe kompetencave shkencore të thelluara në kuadër të zhvillimit dhe kontributit në ekonomi, shoqëri dhe politikë.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Programi i studimit Master garanton dhe mundëson liritë akademike të personelit, duke u bazuar te parimet më të mira europiane të arsimit.

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Po. Përtej pjesës ku studentët kanë aktivitetin shkencor të detyruar, si punimi i diplomës apo detyrave të kursit të ndryshme, ato nxiten nga pedagogët të bëhen pjesë e projekteve të tyre kërkimore. Përfshirja e studentëve është një element që UET e ka theksuar si tek Vizioni ashtu edhe tek Objektivat Strategjike të Strategjisë së Kërkimit Shkencor.<sup>55</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Programi i studimeve master PoSIG, duke angazhuar së bashku universitete partnere nga vendet e Bashkimit European dhe vendet e rajonit, krahas dy institucioneve vendase si UET dhe UT, i përgjigjet më së miri plotësisht të këtij kriteri.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>UET është një institucion pionier në Shqipëri për sasinë dhe mënyrën e financimit të kërkimit duke dedikuar 75,000 Euro në vit. Akademikët në UET janë të inkurajuar që të hulumtojnë dhe të publikojnë dhe në bazë të performancës marrin grantet e tyre kërkimore. Lidhja e shpërblimit financiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet. Në këtë mënyrë universiteti shmang shpërdorimin e burimeve, shpërblen ata që janë më aktivë dhe produktivë në kërkim, dhe krijon një mjedis ku kërkimi është pjesë integrale e jetës universitare.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.8</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Evidentohet se UET ka krijuar një mjedis motivues të kërkimit shkencor për personelin akademik dhe studentët. Njëkohësisht institucioni ka fusha të mëdha kërkimore që emërtohen si Projekteve të Mëdha Kërkimore (PMK). Institucioni ka siguruar bashkëpunim me një sërë institucione partnere në projekte shkencore ndërkombëtare.<sup>56</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitare kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET. Për ta arritur këtë gjë UET angazhon stafin akademik në veprimtari kërkimore shkencore, për të cilët ofron edhe grant kërkimor.</p>

<sup>55</sup> Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020, pika 1.2 dhe 3.4 (Ref. Nr. 3.1)

<sup>56</sup> Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020, f. 4-5 (Ref. Nr. 3.1)

	Gjithashtu mbështet studentët në përfshirjen e tyre në studime shkencore.			
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Referuar Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2017-2020, pika 10, evidentojmë se UET synon ta konsolidojë DSSH <sup>57</sup> si ‘conference of record’ për zhvillimet në hapësirën shqiptare që DSSH të konsolidohet si konferenca më prestigjioze në Shqipëri dhe të pranohet si e tillë edhe nga komuniteti shkencor ndërkombëtar ajo aplikon standardet e mëposhtme: Tërësia e këtyre standardeve, në kohë, do të bëjë që DSSH të krijojë një profil të pakonkurueshëm shkencor në hapësirën shqiptare, i cili do të forcojë më tepër karakterin shkencor të UET dhe do të lehtësojë ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor në UET.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>x</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. <sup>58</sup> Në kuadër të programit PoSIG, pedagogët kanë përdorur <i>EuroPS Teaching Handbook</i> <sup>59</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, <sup>60</sup> ku analizohen disa nga aspektet e veprimtarisë së pedagogut gjatë një ore mësimi në klasë. Vlerësimi kryhet nga një pedagog tjetër/shefi i departamentit që vlerëson programin e lëndës si edhe material të tjera didaktike që pedagogu/ja përdor gjatë orës së mësimi. Vlerësimi bëhet sipas këtyre komponentëve: Organizimi dhe Qartësia e Orës së Mësimi dhe Komunikimi me studentët.

<sup>57</sup> Ditët e Studimeve Shqiptare (Ref. Nr. 55)

<sup>58</sup> Dok. A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref. Nr. 39); Rregullore UET, Kreu V (Ref. Nr. 5); Platforma LMS (Ref. Nr. 46, 46.1, 46.2, 46.3)

<sup>59</sup> Teaching Handbook\_PoSIG (Ref. Nr. 46.4)

<sup>60</sup> G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref. Nr. 30.8)

	<p>Komisioni i Vlerësimit të Performancës së personelit akademik<sup>61</sup> që si rregull, kryesohet nga Rektori dhe ka në përbërje autoritete të larta drejtuese të institucionit, si edhe ekspertë të jashtëm nëse shihet e arsyeshme, interviston në mënyrë individuale secilin pedagog të brendshëm në lidhje me kryerjen nga pedagogu të të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur.</p> <p>Raporti i i Vlerësimit të Performancës së personelit akademik përdoret si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit ndërmjet UET-it dhe personelit akademik të brendshëm, si në drejtim të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punësimit, ashtu edhe të shpërblimit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.<sup>62</sup> Studentët anketohen nëse pedagogu shpjegon mirë, a e bën lëndën interesante apo a e nxit interesin dhe mendimin kritik. Po kështu edhe në kuadër të vetë programit PoSIG organizohen forma vlerësimi të pedagogëve nga studentët.<sup>63</sup></p> <p>Gjithashtu, në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka marrë shpjegimet përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.<sup>64</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit dhe pedagogët marrin Raportin e Vlerësimit të Studentëve, si për lëndët e zhvilluara semestrin e parë ashtu edhe për semestrin e dytë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet e marra diskutohen edhe në mbledhje departamenti edhe me pedagogët në mënyrë individuale në fund të vitit akademik kur kryhet vlerësimi i stafit akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<sup>61</sup> Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore, pika G.I.11 (Ref. Nr. 11)

<sup>62</sup> G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

<sup>63</sup> Teaching Handbook\_PoSIG, 4.9 Regularly Evaluate Your Course, (Ref. Nr. 46.4)

<sup>64</sup> Rregullore UET, Neni 32. (Ref. Nr. 5)

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale dhe orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga UET dhe Universitetet Partnere. <sup>65</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik e plotëson këtë kriter. Komentet e studentëve për programin e studimit mbi format e mësimdhënies dhe vlerësimin kanë qenë gjithmonë një bazë e mirë për të përmirësuar punën. Sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, studentët me nevoja të veçanta dhe/ose me sëmundje kronike nuk do të jenë subjekt i asnjë forme diskriminimi. Të gjitha Universitetet Partnere Europiane janë të përkushtuar të zbatojnë parimet bazë të Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Nevoja të Veçanta, sikurse janë edhe subjekt i ligjeve jo-diskriminuese vendase dhe politikave të diskriminimit pozitiv. <sup>66</sup> Po kështu organizimi i programit të studimit bëhet në përputhje me nevojat e programit përsa i përket tipologjisë së lëndës, numrit të studentëve dhe tematikës së lëndës. <sup>67</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Po ky kriter plotësohet. Klasat janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme për të prezantuar filma/video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet në ppt ose forma të tjera që pedagogu i quan të nevojshme. Po kështu pedagogët janë të inkurajuar dhe janë ndihmuar të ftojnë të ftuar/ekspertë në lidhje me leksionin e rradhës. Platforma online (LMS <sup>68</sup> për UET dhe Mahara Portfolio dhe EuroPS-Moodle –eLearning- për PoSIG <sup>69</sup> ) e shtrin procesin e mësimdhënies edhe jashtë ambienteve të klasës.  Personeli akademik ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh në kuadër të PoSIG (Salzburg- mars 2016, Ljubjanë – prill 2016, Pavia – maj 2016, Sarajevë – Qershor 2017) që ka qenë faza përgatitore e programit. Po kështu përmes programeve të shkëmbit Erasmus+ ka patur mundësi të udhëtojë në vende të ndryshme të BE për të dhënë mësim dhe marrë eksperiencë nga këto universitete. <sup>70</sup>

<sup>65</sup> Rregullore UET, Kreu V. (Ref. Nr. 5); Teaching Handbook\_PoSIG, 4.3 Guiding Principle C: student centred teaching - and the use of ECTS, 4.7 Assessment, (Ref. Nr. 46.4)

<sup>66</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit, Shtojca A, General Provisions, pika 8, f. 23 (Ref. 7)

<sup>67</sup> Rregullore UET, neni 18 (Ref. Nr. 5)

<sup>68</sup> Learning Management System (Ref. Nr. 46.1-46.3)

<sup>69</sup> Teaching Handbook\_PoSIG, seksioni 4.8 dhe 6 (Ref. Nr. 46.4)

<sup>70</sup> Raport rreth zbatimit të projektit (Ref. Nr. 38); Të dhëna mbi shkëmbimet e stafit (Ref. Nr. 43.3)

<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Po personeli akademik e plotëson këtë kriter. Eksperienca brenda dhe jashtë institucionet, si dhe trajnimet e ndryshme bëjnë të mundur që personeli akademik të jetë kompetent në lidhje me lëndën dhe metodat didaktike që përdor.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes: a. vlerësimit të Dekanit, Përgjegjës të Departamentit dhe/ose përgjegjës të grup-lëndës përkatës; b. vlerësimit të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatin e tyre, si dhe focus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; c. vetëvlerësimit; d. rezultateve të raporteve të KSBC-së; e. vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (follow-up). f. leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara. Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese. <sup>71</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Po personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi gjë që i bën tërheqëse orët e mësimi. Pedagogët e PoSIG i referohen edhe <i>EuroPS Teaching Handbook</i> . <sup>72</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre	Diskutimet në orën e seminarit dhe leksionit dhe prezantimet i japin mundësi studentit të shprehë mendimin e tij në mënyrë të pavarur. Po kështu përdorimi i ePortfolio i jep mundësi studentit të jetë ‘pronari’ i platformës the të tregojë se çfarë ka mësuar, të tregojë kompetencat e tij/saj përmes zhvillimit të hapësirës së tij dhe në të njëjtën kohë të reflektojë progresin e tij/saj në të mësuar (për më shumë detaje shih pika 4.8 <i>Use of ICT</i> në <i>EuroPS Teaching Handbook</i> ).			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b> <b>X</b>

### Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës

<sup>71</sup> Rregullore UET, Neni 22, (Ref. Nr. 5)

<sup>72</sup> Teaching Handbook\_PoSIG, seksioni 4.5 dhe 4.6 (Ref. Nr. 46.4)

	janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Ambientet e UET janë gjithmonë të pastra si rrjedhojë e punës shumë të mirë që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit. <sup>73</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	UET ka aktualisht në përdorim 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me software-t përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë software-t e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace dhe Word. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Ky kriter plotësohet. Pedagogët dhe studentët shfrytëzojnë programet PPT, R, LMS, Moodle eLearning dhe MAHARA Portfolio për të realizuar me sukses programin mësimor. <sup>74</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Po, ky kriter plotësohet. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Po, ky kriter plotësohet. Biblioteka e UET zotëron 6071 tituj librash/revistash në hapësirën e saj. <sup>75</sup> Po kështu ambjentet e UET janë komode për studentët që duan të studiojnë aty (Për më shumë detaje rreth hapësirave të bibliotekës konsultu pikën IV.3.1 të këtij raporti). Regjistrimi, përdorimi i librave/materialeve të ndryshme, detyrat e punonjësve të bibliotekës, si edhe procedurat që duhen ndjekur për pasurimin e bibliotekës, rregullohen me dokument të veçantë. <sup>76</sup>  Duhet patur parasysh që duke qenë se PoSIG është një Mastër i Përbashkët, studentët kryejnë vetëm një semester në UET. Në pjesën tjetër ata shfrytëzojnë bibliotekat e universiteteve partnere.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave	Ky kriter plotësohet. Studentët dhe pedagogët përmes aksesit në SAGE dhe EBSCO kanë akses në literaturën më të fundit bashkëkohore. Kjo literaturë mund të aksesohet si në mjediset e Universitetit ashtu edhe jashtë tij.

<sup>73</sup> Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit (Ref. Nr. 42)

<sup>74</sup> Teaching Handbook\_PoSIG, pika 4.8 Use of ICT (Ref. Nr. 46.4)

<sup>75</sup> Te dhena statistikore për fondin e Bibliotekës (Ref. Nr. 45)

<sup>76</sup> Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës (Ref. Nr. 45.3)

të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Po, mjediset laboratorike dhe mjetet që ndodhen në to shfrytëzohen nga studentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre akademike si laboratorë, realizim detyrash krusi, diploma apo prezantime.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në UET, si pedagogët ashtu edhe studentët përdorin LMS (Learning Management System). Leksionet, materialet shtesë, leximet, detyrat, vlerësimet dhe përgjithësisht gjithë komunikimi zhvillohet përmes kësaj platforme. Studentët e PoSIG, përveç LMS që përdorin kur studjojnë në UET, përdorin edhe Mahara ePortfolio dhe Moddle eLearning në funksion të procesit mësimor kur e zhvillojnë mësimin në universitetet partnere.
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Po ky kriter plotësohet. Si studentët ashtu edhe pedagogët shfrytëzojnë LMS (UET) dhe Moddle eLearning (PoSIG) për të komunikuar: për të ofruar leksionet, materiale të ndryshme leximi, video, për të komunikuar pikët e vlerësimit, për të organizuar seancat sqaruese dhe çfarëdolloj komunikimi tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mësimin.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Sipas rregullores së UET, pedagogët plotësojnë formularin ku paraqiten fushat e tyre të ekspertizës në fillim të vitit akademik. Studentët propozojnë pedagogun dhe temën që duan të zhvillojnë në përputhje me interesat e tyre. Në përfundim të procesit të aplikimit për temë diplome dhe udhëheqës, shpallen temat e miratuara të diplomave me udhëheqësit përkatës. Gjatë seancave metodologjike që zhvillohen për 10 javë, çdo të premtë gjatë semestrit të dytë, studentët orientohen dhe udhëhiqen nga pedagogët në lidhje me temën e diplomës. Dokumenti <i>B.II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit</i> tregon me detaje të gjitha fazat në të cilat kalon një punim diplome si dhe strukturën e tij. <sup>77</sup>  Po kështu marrëveshja e bashkëpunimit për PoSIG, parashikon për mbrojtjen e diplomës se Teza e Masterit shërben për të treguar se studenti ka fituar aftësitë për të kryer kërkim shkencor në mënyrë të pavarur në fushat e shkencave politike, në përputhje me metodat dhe standartet bashkëkohore të kërkimit shkencor. Teza është një projekt kërkimor individual, që evidenton fushën e specializimit të studentit. Supervizohet nga dy udhëheqës dhe duhet të jetë e lidhur me fushën e tyre kërkimore dhe/ose të mësimdhënies. Tema e dizertacionit duhet të jetë e lidhur me një prej dy moduleve të përzgjedhur prej studentit/es. Gjatësia e tezës së masterit është midis 25,000-30,000 fjalëve (me përjashtim të anekseve dhe tabelave/bibliografisë). Studentët duhet të ndjekin seminarin e tezës që ka për qëllim të ndihmojë studentët të

<sup>77</sup> Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10)



	zhvillojnë tezën e tyre. Supervizimi i tezës është përgjegjësi e përbashkët e dy udhëheqësve, ku një pedagog duhet të jetë pjesë e fakultetit në Universitetin e Salzburgut apo Lubjanës, ndërsa tjetri duhet të përfaqësojë Universitetet Partnere në Sarajevë, Tiranë, Shkup apo Prishtinë. Udhëheqësit veprojnë njëkohësisht edhe si vlerësues gjatë mbrojtjes së tezës. Komisioni vlerësues konsiston në lektorë prej të gjitha universiteteve partnere (IAL) në të cilat studenti ka ndjekur studimet e tij/saj dhe në të njëjtën kohë janë lektorë që përfaqësojnë të dy modulet e ndjekura prej studentit/es. <sup>78</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Një ndër njësitë kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshin stafin akademik është Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve misioni i së cilës është të ndihmojë në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të UET-it. Në sajë të programeve të shkëmbimit Erasmus+ stafi i universitetit dhe stafi i përfshirë në programin PoSIG ka pasur mundësi të fitojë eksperiencë ndërkombëtare përmes mësimdhënies në universitete perëndimore, por edhe përmes pedagogëve të ftuar nga këto universitete për të dhënë mësim në UET. <sup>79</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimin nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta, por jo vetëm. Stafi dhe studentët e dinë që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të mësimdhënies, gjë e cila rrit vetëdijen për cilësinë e mësimdhënies. <sup>80</sup>

<sup>78</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit, pika 4 Exams, Master's Thesis and Master's Thesis Defence (Ref. Nr. 7)

<sup>79</sup> Outgoing staff (Ref. Nr. 43.3); Raport rreth zbatimit të projektit, pika 8 (Ref Nr. 38)

<sup>80</sup>Dokumenti F.V. Për organizimin dhe funksionimin e departamentit (Ref. Nr. 6)

<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Në formatin që përdoret për hartimin e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë në një seksion të veçantë listën e materialeve audio-vizuale që do të përdoren në mësimdhënie.<sup>81</sup> Shih edhe pikën <i>III.1.1</i> të këtij raporti.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Disa nga aktivitetet traditë të universitetit janë: Ditët Letrare të Razmës, Anuarët e Filozofisë, Liberalët e Dardhës, Shkolla e Lidershipit, Shkolla Dimërore për Inovacion, Shëndeti Publik, New media trends. Stafit akademik i PoSIG ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor si psh. SEEDS: rendesia e arkivimit të të dhënave studimore në Shkencat Sociale në Shqipëri më 18 maj 2017; Conference: Bridges Within Europe-Sarajevo, BiH më 7-11 qershor 2017; How to publish your research më 29 qershor 2017, Staff Development (Pedagog Plus) më 4-5 korrik 2017; Metodologjitë e Kërkimit Inovativ nga COORP dhe Sussex University më 7-10 nëntor 2017; Undertaking and Publishing Impactful Research më 24-25 prill 2018; Metoda Kërkimi Sasiore – European Social Survey, 12 mars 2019; Winter School: European Social Survey round 9 in Albania, 8-9 mars 2019.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i UET ka mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave të reja, përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1.<sup>82</sup></li> <li>b. Trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, apo njësi të tjera).</li> </ol>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Duke qenë se institucionet që marrin pjesë në konsorcium vijnë nga kultura të ndryshme, ka qenë që në fillim e kuptueshme që ata mund të kenë perceptime të ndryshme se çfarë nënkuptohet me praktika të mësimdhënies së mirë. Prandaj, për t'u siguruar që mësimdhënia të realizohet në nivel të lartë në çdo institucion, është krijuar/hartuar libri/manuali për mësimdhënie të mirë. Ky libër ofron një paraqitje të mjedisit mësimor të ICT (Information and Communication Technology – Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit) duke ofruar udhëzime se si mund të përdoren eLearning platform, ePortfolio platform, programi kundër plagjaturës dhe JDMS (Joint Degree Management System- Menaxhimit të Sistemit të</p>

<sup>81</sup> Formatin për hartimin e silabusit (Ref. Nr. 19.1)

<sup>82</sup> Të dhëna për shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43.3)

	Masterit të Përbashkët) i EuroPS. Po kështu libri jep udhëzime të përgjithshme për pedagogët e përfshirë në program, duke përfshirë këtu edhe se si ta përdorin sistemin e ECTS në mënyrën e duhur dhe në të njëjtën kohë ka shërbyer edhe si baza e trainimeve të mëparshme dhe edhe i atyre që do të bëhen në të ardhmen. <sup>83</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Po, ky kriter plotësohet. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Shih pikën III.2.3 të këtij raporti.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Po, ky kriter plotësohet. Angazhimi i lektorëve të ftuar <sup>84</sup> , të cilët janë profesionistë të fushës, shihet si element shumë i rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës. Shembujt nga jeta reale dhe analiza e ekspertëve bën që tema të bëhet më e prekshme për studentët dhe të përvetësohet më lehtë. Kjo bën që edhe rezultatet e të nxëniet të jenë më të larta.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen të detajuara në rregullore. <sup>85</sup> Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Gjithashtu, studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Për studentët që kryejnë një semestër/vit në UET në kuadër të PoSIG, Marrëveshja e Masterit të Përbashkët, parashikon se kurset dhe testimi zhvillohen sipas rregullave të universitetit partner (në këtë rast UET). Universitetet partnere kanë rënë dakord për konvertimin e pikëve. <sup>86</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të	Në fillim të çdo semestri studentët njihen me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim

<sup>83</sup> Teaching Handbook\_PoSIG (Ref. Nr. 46.4)

<sup>84</sup> Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore, pika G.I.4, (Ref. Nr. 11)

<sup>85</sup> Rregullore UET, Kreu V, f. 7 (Ref. nr. 5)

<sup>86</sup> PoSIG\_Marrëveshja e programit, Pika 4 Exams Master's Thesis and Master's Thesis Defence, Appendix C, (Ref. 7)

parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me e-mail nga koordinatori e departamentit.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Kontrolli i njohurive realizohet nëpërmjet: a. Angazhimit në diskutime, por edhe me detyra të kontrolluara përgjatë seancave mësimore; b. Detyrave tematike të përgatitura në mënyrë gjysmë të pavarur nga ana e studentit; c. Provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar; d. Për studentët cilësorë, rekomandim për të kaluar provimin përfundimtar edhe duke u bazuar në një bibliografi në gjuhë të huaj, të përzgjedhur personalisht nga studentit, me këndvështrime alternative, nën drejtimin dhe kontrollin e pedagogut të lëndës; e. Kontrollit edhe për atë pjesë të bibliografisë që duke u konsideruar e detyrueshme, është dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur nga ana e studentit. <sup>87</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë. a. Nxiti studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare. <sup>88</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni përdor programin turnitin/ephorous që prej 16 tetor 2015 për të evituar plagjaturë e eseve dhe temave të diplomës.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në lidhje me PoSIG, Marrëveshja e Bashkëpunimit parashikon se: “Supervizimi i tezës është përgjegjësi e përbashkët e dy udhëheqësve, ku një pedagog duhet të jetë pjesë e fakultetit në Universitetin e Salzburgut apo Lubjanës, ndërsa tjetri duhet të përfaqësojë Universitetet Partnere në Sarajevë, Tiranë, Shkup apo Prishtinë.

<sup>87</sup> Dokumenti A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes (Ref. Nr. 39)

<sup>88</sup> Dokumenti A.IV. Sistemi i vleresimit te studenteve (Ref. Nr. 7.1)

	Udhëheqësit veprojnë njëkohësisht edhe si vlerësues gjatë mbrojtjes së tezës. Komisioni vlerësues konsiston në lektorë prej të gjitha universiteteve partnere (IAL) në të cilat studenti ka ndjekur studimet e tij/saj dhe në të njëjtën kohë janë lektorë që përfaqësojnë të dy modulet e ndjekura prej studentit/es.”
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. <sup>89</sup> Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Po, ky kriter plotësohet. Sikurse theksohet edhe në dokumentin Rregulloren e UET ( <i>Neni 27 Provimet</i> ): 27.8 Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve. Po kështu në <i>Broshurën e Dokumenteve</i> , në seksionin <i>A.V.2.1 Detyrat e pedagogut</i> , specifikohet se pedagogu: d. Jep udhëzimet përkatëse lidhur me zhvillimin e provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar; e. Sqaron dhe argumenton vlerësimin e marrë nga studentin për çdo detyrim të lëndës. Në të njëjtin dokument në seksionin <i>A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve</i> përcaktohet se: Vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe jo penalizuese. Ai synon të tregojë se çfarë di studentin dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë qëllim çdo vlerësim i pedagogut duhet të shoqërohet me koment të përkatës. <sup>90</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Gjatë zhvillimit të provimeve, provimi /salla ku zhvillohet testimi monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë të caktuar me miratim nga Departamenti dhe që të dy apo më shumë janë njëllor përgjegjës për ecurinë e provimit në sallë. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar nga Departamenti, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. <sup>91</sup> Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. <sup>92</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në	Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese. Në rastin e riprovimeve,

<sup>89</sup> Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1); Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika E.I.8.6 (Ref. Nr. 9)

<sup>90</sup> Rregullore UET, Neni 27 (Ref. nr. 5); Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1)

<sup>91</sup> Dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6. (Ref. Nr. 7.1)

<sup>92</sup> Rregullore UET, Neni 33, (Ref. Nr. 5)

kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë. <sup>93</sup> Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online. Ai informohet nga koordinatoresha e departamentit për orarin që pedagogu ka vendosur për zhvillimin e seancës sqaruese. Gjatë kësaj seance, pedagogu i jep mundësi çdo studentit të rishikojë tezën dhe e informon në lidhje me përgjigjet e pyetjeve dhe elementët ku ai ka gabuar.								
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Pas seancave sqaruese, nëse studentit i mbetet i bindur se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, atëherë mund t'i drejtohet Departamentit me kërkesë për rivlerësim. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. <sup>94</sup> Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						

<b>Standardi III.7</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Po. Ky kriter plotësohet. Programi i Masterit është në nivelin 7 (shtatë) të Kuadrit Europian të Kualifikimit, të përcaktuar nga Parlamenti Europian dhe Këshilli Europian. Organizimi i masterit në pesë module prej të cilave studentët zgjedhin dy module krijon mundësi për studim të thelluar. Kurset e avancuar në metodologji dhe lëndë aplikative plotësojnë orientimin substancial të moduleve të programit. Kjo mënyrë organizimi ndihmon studentët të kryejnë në mënyrë të pavarur kërkim shkencor, të zhvillojnë strategji kërkimore dhe ofrojnë zgjidhje për probleme të rëndësishme shoqërore. Duke qenë se gjuha e mësimdhënies dhe mësimnxënies është ajo angleze, kjo krijon mundësi për thellim të njohurive për shkak të korpunit të madh të literaturës që ekziston në këtë gjuhë.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Po, ky kriter plotësohet. Qëllimi i programit është që kur studentët të diplomohen të kenë:

<sup>93</sup> Rregullore e UET, neni 27 (Ref. Nr. 5)

<sup>94</sup> Rregullore e UET, Neni 32 (Ref. Nr. 5)

<p>veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>a- kompetenca në fushën e tyre të studimit (njohuri të thella mbi teoritë e shkencave politike, koncepteve politike, aktorëve, institucioneve, proceseve, normave dhe fushave kryesore të politikëbërjes në modulet që kanë ndjekur; të kenë aftësinë për të kuptuar, vlerësuar dhe aplikuar metodologjinë e kërkimit shkencor; të kenë aftësi për të analizuar problemet politike dhe shoqërore mbështetur mbi konceptet dhe teoritë e shkencave sociale);</p> <p>b- Kompetenca në metodologji (aftësi dhe dije për të aplikuar në mënyrë kritike instrumentet metodologjik të kërkimit shkencor empiriko-analitik në shkencat sociale, duke përfshirë këtu aftësinë për të përdorur programe statistikore, dhe të planifikojnë dhe kryejnë kërkimi shkencor të pavarur; aftësi për të bashkëpunuar me të tjerë në mënyrë ndër-disiplinare ose në grupe dhe për të kryer kërkim shkencor në grup; aftësi për të prezantuar në mënyrë bindëse kërkim shkencor kompleks dhe gjetjet e tij përballë audiencës;</p> <p>c- Kompetenca në sferën praktike (aftësi për të identifikuar problemet politike dhe sociale, për të zhvilluar strategji praktike për gjetjen e zgjidhjeve dhe prezantimin e tyre në debatet publike; aftësi për të lidhur shkencën me praktikën politike; aftësi për t'u angazhuar në mënyrë efektive në politikë për të ofruar një këndvështrim shkencor).<sup>95</sup></p> <p>Studentët e programit do të kenë një profil akademik unik që krijohet për shkak të fushave të specializimit, trupës ndërkombëtare të studentëve dhe pedagogëve dhe mobilitetit personal që lëviz midis universiteteve partnere të BE dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Për shkak të praktikës (që është e detyrueshme) studentët do të fitojnë ekspertizë specifike në lidhje me kushtet sociale, ekonomike dhe proceset politike në Ballkanin Perëndimor.</p> <p>Përveç dijes, aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e studimit, për shkak të mobilitetit ndërkombëtar, studentët do të fitojnë dije në një gjuhë të huaj; do të fitojnë aftësi organizative si rezultat i orientimit dhe të kuptuarit të strukturave burokratike dhe organizacionale në një universitet të huaj, do të zgjerojnë perspektivën në fushën e tyre studimore dhe do të fitojnë aftësi komunikimi ndërkulturale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Si rregull, pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Eseja, apo detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës është një formë e shqyrtimit të</p>

<sup>95</sup> PoSiG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14)

	aftësisë së studentëve për të kuptuar çfarë ata kanë përfituar nga lënda.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në orën e fundit të mësimit, pedagogu përveçse ndalet edhe njëherë në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Kontributi individual i secilit pedagog në kërkimin shkencor zhvillohet sipas drejtimit të kërkimit ku pedagogu është i përfshirë. Pedagogët e UET pasi informohen dhe studiojnë në varësi të drejtimit që ata kanë për zhvillimet dhe të rejat e shkencës dhe teknologjisë, zhvillojnë seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor, për të informuar kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit të disiplinave që përbëjnë këtë program studimor.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.	Mësimdhënia në UET synon të gërshetojë njohuritë teorike me aftësitë praktike, përmes ushtrimeve dhe detyrave ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Ndaj në secilën lëndë të programit është parashikuar të zhvillohet një detyrë kursi, e cila ka 20% të vlerësimit përfundimtar. Gjithashtu, lëndë të caktuara të programit zhvillohen në formate simulimesh, ku studentët e këtij masteri anën teorike të leksioneve të marra e zbatojnë praktikisht. Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Po, ky kriter plotësohet. <i>Detyra në Grup</i> është e vetmja formë kolektive e vlerësimit. Ajo vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup. Detyra duhet të ideohet si kolektive dhe të përfundojë si e tillë. Çdo anëtar i grupit duhet të realizojë në mënyrë të përgjegjshme pjesën që i takon. Këto pjesë individuale kombinohen së bashku për të formuar një produkt të grupit. Disa lloje të detyrës në grup janë: a) zgjidhja e një kauzi (në fusha si shkencat juridike), b) hulumtimi i një rasti studimor dhe raportimi mbi të; c) planifikimi dhe zbatimi i një projekti; d) nën-lloje të tjera të specifikuar nga titullari i lëndës dhe të miratuara nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Në këto raste roli dhe kontributi i secilit student duhet të identifikohen qartë, me synim që



	të argumentohet vlerësimi i dhënë për përmbushjen e objektivave të kontrollit. <sup>96</sup>			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Po, ky kriter plotësohet. Shiko Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Personeli akademik nxitet edhe përmes stimuluesh financiarë që të bëhet pjesë e projekteve, të publikojë në revista shkencore me faktor impakti, dhe të bashkëpunojë me kolegët në kuadër të grupeve kërkimore të organizuara në nivel njësie bazë/kryesore dhe institucioni. Gjithashtu personeli akademik kërkohet të inkurajojë edhe përfshirjen e studentëve, sidomos atyre të ciklit të tretë, dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave, në punën kërkimore shkencore.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Sipas “Strategjisë së Kërkimit Shkencor; Vizioni, pika 1.2, Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafik akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. <sup>97</sup>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Po, ky kriter plotësohet. Dhe natyra e vetë programit që zbatohet nga konsorciumi i universiteteve e lehtëson këtë gjë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Po ky kriter plotësohet. Në dokumentacionin e brendshëm rregullator të UET <sup>98</sup> sqarohet shumë qartë se si funksionon procesi i mbrojtjes së diplomës (Për nivelin MSH ka vetëm mbrojtje diplome). Duke qenë se ky program është i përbashkët, procedura specifike që ndiqet është e përcaktuar në marrëveshjen për ofrimin e programit. <sup>99</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Asistenca ndodh si gjatë seancave metodologjike (shih pikën III.3.10 të këtij raporti) ashtu edhe përmes takimeve të tjera dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera (LMS, Mahara, Moodle) që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës.

<sup>96</sup> Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.3.4. (Ref. Nr. 7.1)

<sup>97</sup> Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020 (Ref. Nr. 3.1)

<sup>98</sup> Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. nr. 10)

<sup>99</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit (Ref. nr. 7)

<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Po ky kriter plotësohet. Për më shumë detaje shih pikën <b>III.3.10</b> dhe pikës <b>III.8.6</b> të këtij raporti.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Po ky kriter plotësohet. Për më shumë detaje shih pikën <b>III.3.10</b> dhe <b>III.8.6</b> të këtij raporti.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Po ky kriter plotësohet. Për më shumë detaje shih pikën <b>III.3.10</b> të këtij raporti. Sipas <i>pikës B.II.5.2 të Broshurës së Dokumenteve</i>, seancat metodologjike trajtojnë çështje të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Përcaktimin shkencor të objektit të studimit;</li> <li>b. Diskutimin e dobisë së punimit;</li> <li>c. Përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet;</li> <li>d. Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre;</li> <li>e. Trajtimin e aspekteve metodologjike;</li> <li>f. Ndërtimin e strukturës së punimit;</li> <li>g. Përcaktimin dhe shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi (me <i>Burime Parësore/Dokumente Burimore</i> do të kuptojmë të dhënat që dalin nga puna e drejtpërdrejtë në terren dhe që nuk janë publikuar më parë me <i>Burime Dytësorë/Literaturë</i> mund të kuptojmë të gjitha ato burime të cilat janë publikuar, shpërndarë dhe përdorur më parë dhe që nuk dalin nga puna e studentit në terren) ;</li> <li>h. Përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj) ;</li> <li>i. Punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave;</li> <li>j. Hartimin e punimit të diplomës;</li> <li>k. Debatimin e përfundimeve të studimit.</li> </ol> <p>Pedagogu drejtues i seancave metodologjike pranon, vlerëson dhe paraqet në Sekretarinë Mësimore dosjen e strukturave të punimeve të studentëve që marrin pjesë në këto seanca.<sup>100</sup></p> <p>Në përfundim të punimit, pedagogu plotëson formularin <i>B-II-13-2 Formulari i vleresimit të diplomës nga Udhëheqësi-Oponenti (MSH)</i>, ku miraton ose jo punimin e paraqitur dhe jep edhe vlerësimin e tij në lidhje me punimin e diplomës para komisionit.</p>

<sup>100</sup> Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit, pikat B.II.5.2 dhe B.II.5.3 (Ref. Nr. 10)

<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Po, ky kriter plotësohet. Punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. <sup>101</sup>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Po, në përfundim të studimeve studenti pajiset diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratura nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe e firmosur prej universiteteve partnere ku studenti ka zhvilluar studimet e Masterit të Përbashkët. Një kopje e formatit të Diplomës i është bashkëngjitur këtij raporti.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të silabuseve të programit të studimit të zhvilluar.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.			
<b>Shkalla e përmbyshjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbyshet</b>	<b>Përmbyshet pjesërisht</b>	<b>Përmbyshet kryesisht</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbyshjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbyshet</b>	<b>Përmbyshet pjesërisht</b>	<b>Përmbyshet kryesisht</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit	Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, <sup>102</sup> e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme, në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni <sup>103</sup> . Zyra e Burimeve Njerëzore mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.

<sup>101</sup> Dokumenti B.II. Për punimin e diplomës, pika B.II.13.4 (Ref. Nr. 10)

<sup>102</sup> Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

<sup>103</sup> Format Dosje Stafit Akademik (Ref. Nr. 44 & 44.1)

ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.									
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Për shkak të natyrës së programit, procesi i përzgjedhjes së personelit dhe trainimit të tyre është kryer që në vitin 2016-2017. Lektorët e lëndëve dhe lëndët që ata vetë japin në kuadër të Masterit PoSIG kanë plotësuar kriteret si vijon për tu bërë pjesë e programit: eksperiencë në kërkim shkencor dhe mësimdhënie, përfshirje në aktivitete ndërkombëtare si shkëmbime stafi, pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca, përputhje të plotë të lëndës me kërkesat e kurrikulës së PoSIG-ut në lidhje me lëndët, metodologjinë mësimdhënëse, metodologjinë e vlerësimit/testimit, pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet e menaxhimit të cilësisë dhe në platformën e-Learning të EuroPS. Vetë UET-i ka procedura të qarta në lidhje me rekrutimin e personelit. <sup>104</sup>								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik janë të parashikuar në dokumentin përkatës, në të cilin përcaktohen fazat nga evidentimi i nevojave për personel të ri e deri tek vlerësimi i performancës së personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit <sup>105</sup> , rrjetet sociale <sup>106</sup> dhe në Gazetën Liberale.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit <sup>107</sup> . Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni është i angazhuar në krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Kapacitetet infrastrukurore në dispozicion, salla e departamenteve, zyrat dyshe, zyrat individuale të

<sup>104</sup> Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

<sup>105</sup> Faqja zyrtare e UET <http://uet.edu.al/new/thirrje-aktuale-per-punesim/>

<sup>106</sup> Shembull thirrje për staf akademik (Ref. 11.1)

<sup>107</sup> Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 22 (Ref. Nr. 5); Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

	drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisit të përshtatshëm <sup>108</sup> .			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Zhvillimi profesional i stafit është një ndër objektivat strategjik të institucionit, i cili garantohet si nga zhvillimi i aktiviteteve nga vetë institucioni ashtu edhe nga mbështetja institucionale për stafin për të ndjekur trajnime dhe aktivitetet të tjera zhvillimore në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit <sup>109</sup> . Zhvillimi i konferencës shkencore ‘Ditët e Studimeve Shqiptare’ sikurse dhe botimi i revistave shkencore (Revista Polis e specializuar në fushën e shkencave sociale) janë disa nga treguesit e rëndësishëm që institucioni i kushton zhvillimit të vazhdueshëm të stafit. Përfshirja në një numër të konsiderueshëm projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, është një tjetër tregues i strategjisë së institucionit në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të stafit <sup>110</sup> . Për detaje më të hollësishme shih edhe pikat <b>III.3, III.6, III.7, III.4.1</b> të këtij raporti.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Po ky kriter plotësohet. Shih kriterin 2 më sipër.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Po, ky kriter plotësohet. Tabela e stafit akademik të përfshirë në program, e tregon qartë këtë. <sup>111</sup> Po kështu Universiteti në Broshurën e Dokumenteve përcakton qartë kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës <sup>112</sup> mësimore në funksion të angazhimit optimal të burimeve njerëzore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në	Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike <sup>113</sup> .

<sup>108</sup> Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

<sup>109</sup> Statuti UET, Neni 6, pika 6.3 (Ref. Nr. 2); Trajnim mbi sistemin UET LMS (Ref. Nr. 43.1); Të dhëna mbi shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43.3); Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik (Ref. Nr. 43)

<sup>110</sup> Projekte UET 2011-2018 (Ref. Nr. 43.2)

<sup>111</sup> Personeli akademik i angazhuar në program (Ref. nr. 24)

<sup>112</sup> Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, G.II. (Ref. Nr. 11)

<sup>113</sup> Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

<p>varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion salla të kapaciteteve të ndryshme duke akomoduar studentë sipas llojit të veprimtarisë dhe në përputhje me normativat në fuqi. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510m<sup>2</sup> dhe 1515 vende. Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45m<sup>2</sup> dhe secila me nga 35 karrige. Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m<sup>2</sup> secila.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me software-t përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj<sup>114</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Nga vetë natyra e këtij programi nuk është e nevojshme zhvillimi i mësimin në laboratore, studio apo atelie.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>4 laboratorët e Informatikës janë në dispozicion edhe për programet e studimit të ciklit të dytë, në kuadër të lëndëve Metoda Kërkimi të Avancuara dhe Metoda Kërkimore Sasiore.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve<sup>115</sup>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### Standardi IV.4

<sup>114</sup> Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS (Ref. Nr. 46.1); UET-LMS Guidë për pedagogun (Ref. Nr. 46.2); UET\_LMS Guidë për studentët (Ref. Nr. 46.3)

<sup>115</sup> Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit (Ref. Nr. 32); Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1)

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e institucionit, e vendosur në godinën C dhe me një sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup> është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë. Studentët e programit MSc. PoSIG kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën fizike të universiteteve partnere ku kryejnë studimet, krahas literaturës dhe abonimeve online të Bibliotekës së UET.</p> <p>Biblioteka ka një staf të kualifikuar që është gjithmonë i gatshëm në ndihmë të studentëve dhe për t'i orientuar ata dhe për të gjetur literaturën që u nevojitet, si edhe për shërbime të tjera bibliotekare. Ajo u shërben studentëve të të gjitha niveleve edhe si një sallë leximi, duke u ofruar atyre komoditetin dhe fasilitetet e nevojshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodik, CD dhe harta), në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Aksesit i literaturës së programit nga studentët, garantohej nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Literaturës fizike në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti. Stafi akademik parashtrohet për blerjen e literaturës nëpërmjet plotësimit të formatit përkatës<sup>116</sup>;</li> <li>2. Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia;</li> <li>3. Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj;</li> <li>4. Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin UET LMS</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Aksesit i studentëve është pa pagesë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage.</p> <p>Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të</p>

<sup>116</sup> Dokumenti E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë (ref. Nr. 45.1); Shembull procedure\_blerje literature (Ref. Nr. 45.2); Inventari i teksteve\_Marrëdhënie ndërkombëtare (Ref. Nr. 45)

	përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. <sup>117</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer pedagogëve dhe studentëve.</p> <p>Pasurimi i fondit të bibliotekës bëhet përmes këtyre rrugëve:</p> <p>(a) Blerja në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkollore si tekste bazë ose si literaturë e rekomanduar;</p> <p>(b) Blerja në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me procesin mësimor në të trija fakultetet e UET-it;</p> <p>(c) Përkthimi dhe botimi nga UET Press i shumë teksteve universitare dhe monografive shkencore që kanë për autorë pedagogë të UET-it, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë. Këtu bëjnë pjesë disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit si dhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga ky universitet, midis të cilave edhe revistat e Fakultetit, si Polis, Sociological Analysis dhe Educatio;</p> <p>(d) Porosive dhe blerja online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet më së miri ekspertiza e UET-it;</p> <p>(e) Të dhuruara nga organizata dhe shoqata të ndryshme, ambasada të huaja dhe individë të ndryshëm.<sup>118</sup></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	<p>Biblioteka e UET shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Oraret janë nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00.</p> <p>Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur. Oraret e shërbimit të bibliotekës janë përshtatur me oraret e programit të studimit dhe me nevojat e studentëve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi**

<sup>117</sup> Te dhena statistikore per fondin e Bibliotekes (Ref. Nr. 45)

<sup>118</sup> Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës (Ref. Nr. 45.3)



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi nëpërmjet të cilit UET administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është sistemi UMIS<sup>119</sup>. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin automatik me anë të email-it ose me SMS për aktivitete të ndryshme, regjistrimi në kurse apo programe të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi UMIS shërben kryesisht për evidentimin e angazhimit të pedagogëve në lëndët që mbulojnë sipas secilit semestër, ndërsa i gjithë aktiviteti i lidhur me procesin e mësimdhënies dhe komunikimit me studentët mbështet në platformën UET LMS.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS. Sistemi i menaxhimit të mësimdhënies online (UET LMS) është standardi më bashkëkohor i përdorur nga gjithë universitetet prestigjioze në botë në informatizimin e procesit të mësimdhënies online. Aktualisht, sistemi UET LMS është azhurnuar më të gjithë informacionin bazë si: Janë regjistruar të gjithë studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; Janë regjistruar të gjitha lëndët që ofrohen në UET, në BA dhe MA, për çdo semestër; Janë regjistruar të gjithë pedagogët përgjegjës për çdo lëndë; Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera; Sistemi jep mundësinë që përpara logimit çdo pedagog apo student të mund të shohë të gjitha lëndët që ofrohen në universitet; Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët.</p>

<sup>119</sup> Manual i përdoruesit të sistemit UMIS (Ref. Nr. 46)

<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Funkzioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma LMS (Learning Management System) është edhe një mjet eficient në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Në përfundim të çdo semestri nxirren statistikat përkatëse për çdo pedagog në lidhje me përdorimin e LMS-së.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Faqja Zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës (UET) në web është: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>. Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organigramën. Faqja zyrtare jep informacion edhe mbi fakultetet, kërkimin shkencor, botimet e UET-Press-it si dhe shërbime të tjera që ofrohen nga UET-i. Një pjesë të rëndësishme të faqes zyrtare e zë pasqyrimi me foto dhe me tekst i aktiviteteve të ndryshme që ndodhin pranë UET-it, si konferenca të ndryshme, seminare, leksione të hapura, takime me personalitete të rëndësishme vendase ose të huaja. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi Guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, silabuset e lëndëve, së bashku me bio të personelit akademik. Përmes faqes zyrtare studentët e UET-it mund të kryejnë një sondazh të shkurtër në lidhje me pikat e forta të UET-it. Aktualisht UET ka ndërtuar faqen e re e cila për momentin është vetëm në gjuhën shqipë, por në një moment të dytë do të jetë edhe në gjuhën angleze. Faqja e mëparshme ishte në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat<sup>120</sup>. Për shkak të përmasave të institucionit por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton</p>	<p>UET ka raport auditit çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave</p>

<sup>120</sup> Të dhëna mbi koston për student (Ref. Nr. 49); Të ardhura dhe financime të ndryshme (Ref. Nr. 50)

raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Procesi nga pranimi deri në dalje mbështetet në: legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse <sup>121</sup> , burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online <sup>122</sup> , në broshurën informuese (Guida UET) dhe Guida për PoSIG <sup>123</sup> , fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse <sup>124</sup> .  Përpos dokumenteve të UET-it, studentët e PoSIG kanë edhe <i>Marrëveshjen e Universiteteve Partnere EuroPS Agreement on the Joint Master's Programme in Political Science – Integration and Governance</i> që specifikon procedurat e pranimit, programin e lëndës, testimin, praktikës profesionale dhe diplomimit të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë	Po, ky kriter plotësohet. Si dokumentet e UET ashtu edhe Marrëveshja e bashkëpunimit tregojnë qartë se të njëjtat

<sup>121</sup> Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1)

<sup>122</sup> <http://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/>; <http://euro-ps.org/admissions/>

<sup>123</sup> [http://euro-ps.org/wp-content/uploads/2017/04/Broshura-PoSiG-Print\\_OK.pdf](http://euro-ps.org/wp-content/uploads/2017/04/Broshura-PoSiG-Print_OK.pdf)

<sup>124</sup> Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28); Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12);

barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	rregulla aplikohen për të gjithë dhe të vetmet raste përjashtimore janë studentët me nevoja të veçanta për të cilët mund të ketë rregullime të ndryshme në lidhje me formën e testimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme, duke garantuar transparencë të plotë. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion, sikurse dhe gjenden në aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve sikurse janë të aksesueshme dhe në intranetin e UET <sup>125</sup> . Po kështu në lidhje me programin PoSIG, studentët mund të konsultojnë web-faqen e programit ku mund të gjejnë një informacion të detajuar në lidhje me pyetjet që mund të kenë <a href="http://euro-ps.org/frequently-asked-questions-faq/">http://euro-ps.org/frequently-asked-questions-faq/</a>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, publikohen në faqen e UET, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë kontakteve me ta, sikurse dhe reflektohen në dokumentet respektive të listuara në kriterin 1 dhe 3 më lart.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Kriteret e programeve të studimit publikohen dhe i vihen në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme të komunikimit. <sup>126</sup> Thirrja për PoSIG bëhet në mes të vitit akademik paraardhës. Për vitin akademik 2019-2020 afati i fundit i aplikimit ka qenë në 01 Shkurt 2019. Në faqen e internetit të programit, në faqen e face-book të programit dhe në njoftimet që bëhen në UET, studentët njoftohen në kohë për mënyrën e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme. Koha e vënë në dispozicion për aplikim është e mjaftueshme për ta kuptuar mirë procesin dhe për të përgatitur një aplikim solid.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët informohen në lidhje me kurset e detyrueshme, modulet karakterizuese, kurset integruese, kurset e detyrueshme me zgjedhje, praktikën dhe temën e diplomës si edhe me numrin e krediteve që marrin për çdo lëndë, semestrin që duhet ta ndjekin dhe universitetin që e ofron. Kjo gjendet në web-faqen e programit <a href="https://euro-ps.org/curriculum/">https://euro-ps.org/curriculum/</a>

<sup>125</sup>Në intranetin e UET ndodhet folderi Dokumenta\_UET në të cilin gjenden aktet rregullatore.

<sup>126</sup> Komunikimi i integruar i marketingut (Ref. Nr. 51); Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online (Ref. Nr. 48)

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme i bëhen të ditura studentëve dhe janë pjesë e dokumenteve rregullatore<sup>127</sup>. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me Departamentet, informojnë studentët dhe bëjnë vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit i bëhen të ditura studentëve dhe parashikohen në rregulloren e programit të studimit. Ato janë pjesë e silabuseve të lëndëve, të cilat i vihen në dispozicion dhe i shpjegohen studentëve që në fillim të procesit akademik<sup>128</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen<sup>129</sup>. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik<sup>130</sup>. Gjithashtu studentët njoftohen nëpërmjet e-mailit për çdo veprimtari akademike, nga kordinatorët e Departamenteve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> <p>Informimi dhe ndërgjegjësimi realizohet nëpërmjet këtyre formave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Organizim, në mjediset e UET-it, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuere me grupe studentësh;</li> <li>b. Takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve;</li> <li>c. Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuere si: fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale etj;</li> <li>d. Organizim logjistik, orientues, të “Javëve të regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës.<sup>131</sup></li> </ol>

<sup>127</sup> Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28)

<sup>128</sup> Silabuset e lëndëve (Ref. Nr 19).

<sup>129</sup> Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10)

<sup>130</sup> Kalendarit akademik 2018-2019 (Ref. Nr. 10.1)

<sup>131</sup> Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, D.I.1.1 (Ref. Nr. 27.1)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Web-faqja e PoSIG ka informacion të detajuar për programin PoSIG në veçanti. Po kështu Marrëveshja e Bashkëpunimit sqaron mënyrën e funksionimit të programit.</p> <p>Programi është organizuar në module dhe lëndë të vlerësuara në kredite, (ECTS). Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programi ofrohet me kohë të plotë.</p> <p>Programi është i akredituar prej Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin e Austrisë për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare duke filluar prej 15 mars 2017.<sup>132</sup></p> <p>Gjuha e mësimdhënies në të gjitha kurset e programit është Anglishtja. Aplikantët duhet të tregojnë njohje shumë të mirë të gjuhës angleze (Niveli B2) si kusht për t'u regjistruar në program. Numri i krediteve të nevojshme për të përfunduar studimet në Masterin Shkencor, Shkenca Politike – Integrimi dhe Qeverisja, është 120 ECTS, që i korespondon 4 (katër) semestrave studimor.</p> <p>Studentët marrin nga tre lëndë të detyrueshme (me vlerë 18 ECTS) prej secilit prej 2 (dy) moduleve të zgjedhura prej tyre (Teori Politike, Politika Krahasuese, Politika Publike dhe Administrim, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Integrim European). Këto janë lëndët e Moduleve të Detyruara me Zgjedhje (Compulsory Elective Modules: 2 prej 5) dhe në të total për të dy modulet kanë vlerën e 36 ECTS. Lëndët e detyruara për të gjitha modulet janë: Praktika, Metodatat e Kërkimit (I), Metodatat e Kërkimit (II) dhe Seminari për Tezën e Masterit, secila me vlerën e 6 (gjashtë) krediteve për një nën-total prej 24 ECTS.</p> <p>Teza e Diplomës që jepet në përfundim të studimeve ka vlerën e 30 ECTS (28 ECTS Teza dhe 2 ECTS Mbrotja). Kështu në përfundim të studimeve studentët kanë 120 ECTS.</p>

<sup>132</sup> AQ\_Confirmation\_PoSiG\_condition\_decision (Ref. Nr. 54)

	<p>Mobiliteti Ndërkombëtar është një ndër tiparet kryesore dhe që i jep vlerë të shtuar programit. Studentët e programit duhet t'i ndjekin studimet e tyre në të paktën 2 (dy), dhe më së shumti në 4 (katër) Universitete Partnere. Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve duhet të përfshijë së paku studimet akademike në një ose dy universitete në Salzburg apo Lubjanë në vitin e parë akademik (60 ECTS) dhe një ose dy universitete në Sarajevë, Tiranë, Shkup apo Prishtinë në vitin e dytë akademik (60 ECTS). Kohëzgjatja e mobilitetit ndërkombëtar duhet të jetë të paktën një semester akademik. Çdo aplikant duhet të specifikojë fushat e specializimit (dy module nga pesë) dhe se në cilat universitete do t'i ndjekë (Salzburg apo Ljublanë) do të ndjekë semestrin e parë apo të dytë. Po kështu studenti duhet të deklarojë se në cilat universitete planifikon të ndjekë semestrin e tretë dhe të katërt. Kjo zgjedhje mund të ndryshojë përpara përfundimit të semestrit të dytë.</p> <p>Praktika nuk konsiderohet mobilitet ndërkombëtar dhe ka vlerën e 6 (gjashtë) ETCS. Ajo konsiston në katër javë punë me kohë të plotë në një institucion. Mund të realizohet me një Kontratë Praktike me kohë të plotë ose me kohë të pjesëshme por me një kohë më të gjatë për tu ekuivalentuar me periudhën katër javore me kohë të plotë. Institucionet mund të jenë lokale, kombëtare ose ndërkombatare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Në web-faqen e programit: <a href="https://www.posig.uet.edu.al">https://www.posig.uet.edu.al</a> dhe <a href="http://euro-ps.org/curriculum/">http://euro-ps.org/curriculum/</a> gjendet informacion i hollësishëm në lidhje me programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> <p>Me përfundimin e studimeve studentët mund të punësohen në: administratën qendrore dhe lokale, parlament dhe parti politike, OJQ, grupe interesi dhe sindikata, sektori i biznesit privat, media dhe marrëdhëniet me publikun, organizata ndërkombatare, të ndjekin karrierë në diplomaci, në institucionet e BE, në organizata ndërkombatare fitim-prurëse ose jo, agjenci dhe organizata që operojnë në sferën e zhvillimit, mund të punësohen në fushën e edukimit (fondacione, think-tanks, akademi etj) dhe mund të ndjekin karriera akademike në unviersitete.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Që në momentin e interesimit e deri në përfundim të studimeve, studentëve i vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm mbi proceset mësimore. Një nga detyrat e koordinatorës së departamentit është mbajtja e kontakteve të rregullta, njoftimeve elektronike dhe me telefon, me studentët që ndjekin programe</p>



	studimi të Departamentit. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatoreve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Po, studentët kanë akses në ePlatform (Mahara), eLearning (Moodle) dhe LMS (studentët që vijnë në UET) për të aksesuar informacionin e nevojshëm.			
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	I gjithë dokumentacioni i studentit, që nga dosja për aplikim dhe regjistrim në programin e studimit, si edhe gjithë rekordet (lëndët që ka ndjekur sipas semestrave, rezultatet e provimeve, deri në diplomim) ruhen në Sekretarinë mësimore dhe Zyrën e Regjistrimit të studentëve, përkatësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Përmes njësive administrative si Zyra e Regjistrimit të Studentëve, Dekani i Studentëve dhe Alumni UET, universiteti ruan të dhënat e studentëve dhe përpunon statistikat në nivel programesh studimi, apo nivel institucioni. Sa i takon studentëve të PoSIG, kjo kryhet edhe në bashkëpunim dhe institucionet e tjera partnere.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Po, ky kriter plotësohet. Aktualisht programi është i ri kështu që nuk mund të flitet ende për mospërfundim të programit në kohë, por vetëm për largime apo ndërprerje para kohe.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Rekordet e studentit, së bashku me rekordet që ndjek në universitetet partnere, ruhen në sistemin elektronik dhe në regjistrat që plotësohen me shkrim. Këto të dhëna

	gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve <sup>133</sup> .			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Departamenti është përgjegjës në hartimin e një raporti analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënies dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. <sup>134</sup> Duke qenë se programi PoSIG është i ri, ende nuk është hartuar raporti i parë analitik, pasi ende nuk janë përpunuar të dhënat për shkallën e diplomimit dhe punësimit të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Format e përfshirjes janë: 1. Përfshirja në procesin e hartimit, diskutimit, rishikimit dhe miratimit të planeve mësimore dhe programeve të studimit, në nivel Departamenti, Fakulteti, dhe në nivel të Senatit akademik përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. 2. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta për të vjelë mendimin e studentëve në lidhje me planet mësimore, me tekstet mësimore, si dhe me përmbajtjen e programeve mësimore dhe me nivelin e cilësisë së tyre. 3. Angazhimi i studentëve për të vlerësuar nivelin, përmbajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet anketimeve, për të dhënë mendimin e tyre për përmbajtjen e programeve të lëndëve, metodave dhe metodologjive të mësimdhënies, nivelit të komunikimit

<sup>133</sup> Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9);

<sup>134</sup> Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit, pika F.V.5.2, gërma h (Ref. Nr. 6)

	<p>të pedagogëve, efektivitetit, cilësisë në zhvillimin e leksioneve dhe seminareve etj.</p> <p>4. Mbledhja e vlerësimeve të studentëve dhe diskutimi i tyre në organet drejtuese të UET-it.</p> <p>5. Përfshirja e studentëve në Senatin Akademik, Dekanat, Këshillin e Etikës, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>6. Takimet e autoriteteve drejtuese me studentët dhe përfaqësuesit e tyre.</p> <p>7. Tryezat e rrumbullakëta me grupe të zgjedhura studentësh.<sup>135</sup></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve garantohej si në mënyrë të drejtpërdrejtë (përfaqësimi në strukturat e analizuara në Kriterin 1, më sipër, ashtu edhe në mënyrë periodike, nëpërmjet zhvillimit të fokus grupeve, pyetësorëve online dhe kërkesave të studentëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Ngarkesa akademike është e shpërndarë në mënyrë të barabartë në semestra (30 ECTS për semestër). Për më shumë detaje shiko dokumentin <b>Plani mësimor i Programit PoSIG</b>. Semestri i fundit i dedikohet punimit të diplomës, në mënyrë që student të ketë kohën e nevojshme për t’iu përkushtuar kërkimit shkencor.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Zhvillimi i fokus grupeve, pyetësorëve online dhe mbledhjeve të hapura të departamenteve shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme<sup>136</sup> sikurse dhe në silabusin e secilës lëndë<sup>137</sup>. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.<sup>138</sup></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<sup>135</sup> D.III. Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET-it, pika D.III.3 (Ref. Nr. 29)

<sup>136</sup> Rregulloret e UET, Neni 24, 27 dhe 32 (Ref. Nr. 5);

<sup>137</sup> Format i silabusit cikli i pare dhe dytë (Ref. Nr. 19.1)

<sup>138</sup> D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve (Ref. Nr. 40.1)

**Standardi V.6**

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Shih CV-të e pedagogëve, bashkëlidhur këtij raporti edhe raportin për punën kërkimore shkencore të stafit të departamentit.<sup>139</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. UET ka zbatuar një sërë projektesh me Universitete/Institute të huaja si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- The Feminine Side of Quality, financuar nga IPA CBC Program, Montenegro – Albania</li> <li>- FromMEtoEU</li> <li>- Steps Erasmus+</li> <li>- Erasmus+ KA2 Capacity Building in Higher Education – PoSIG (2017- aktualisht);</li> <li>- Financial Management, Accounting and Controlling Curricula Development for Capacity Building of Public Administration/FINAC;</li> <li>- Ready for Business/REBUS;</li> <li>- Master in European Agrienvironmental and Rural Development Instruments, Policies, Strategies/SMARTAL;</li> <li>- Strategic Support on Strengthening the Quality Assurance Structures at the Private Higher Education Institutions in Albania/QAINAL;</li> <li>- IT Governance for Albanian Universities/ITG4AU;</li> <li>- Next Europe Network;</li> <li>- European Charter of Researchers;</li> <li>- COORP 2.0- Collaborative Offline and Online;</li> <li>- COST – EUROPEAN COOPERATION IN SCIENCE AND TECHNOLOGY (merr pjesë në 7 Aksione: CA16121;CAIS1308; CA15207; CA15221; CA16207; CA15137; CA16213)</li> <li>- ESPON: Territorial and Urban Potentials Connected to Migration and Refugee Floës;</li> <li>- EDUFOOTPRINT- School Loë Carbon Footprint in Mediterranean Cities;</li> <li>- INNOPLATFORM – Innovations Platform and Tools for Increasing the Innovation Capacity of SMEs in the Balkans Mediterranean Area;</li> <li>- KAP'ECO-COMMUNITY for Clean Ecological Environment;</li> <li>- Improving Local Media Capacities to Fight Religious Radicalism and Violent Extremism in Elbasan;</li> <li>- Erasmus+ Credit Mobility.<sup>140</sup></li> </ul>

<sup>139</sup> Puna kerkimore shkencore e stafit te dept 2018-2019 (Ref. Nr. 43)

<sup>140</sup> Projekte UET 2011-2018 (Ref. Nr. 43.3)

	Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve ndihmon në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të Universitetit duke i ofruar shërbim dhe mbështetje administratës së Universitetit, fakulteteve, dhe stafit për të siguruar dhe për të menaxhuar financim të jashtëm për aktivitete të Universitetit.			
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Po, ky kriter plotësohet. Studentët kanë të gjithë mbështetjen e nevojshme (kur e kërkojnë atë) në rast se duan të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime dhe punime shkencore.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	UET ka krijuar një fond të veçantë, prej 75.000 eurosh, për të nxitur stafin, për të kryer një punë kërkimore shkencore cilësore dhe të botojnë në revista me factor impakti, kryesisht, Thomson Reuters/Clarivate Analytics dhe Scopus. UET mbështet publikimin e punimeve kërkimore në revistat shkencore ndërkombëtare që UET boton siç është revista “Polis”, për studime në shkencat sociale dhe humane.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	N/A			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	<p>Nëpërmjet seancave metodologjike që studenti kryen me pedagogun udhëheqës, ka asistencën e nevojshme që në përcaktimin e temës deri në momentin e mbrojtjes. Madje pedagogu udhëheqës shërben si një garantues i cilësisë së punimit të kryer nga studenti, pasi ky i fundit, nuk futet në mbrojtjen e temës, nëse nuk është e firmosur nga udhëheqësi.<sup>141</sup></p> <p>Po kështu marrëveshja e bashkëpunimit për PoSIG, parashikon për mbrojtjen e diplomës se Teza e Masterit shërben për të treguar se studenti ka fituar aftësitë për të kryer kërkim shkencor në mënyrë të pavarur në fushat e shkencave politike, në përputhje me metodat dhe standartet bashkëkohore të kërkimit shkencor. Teza është një projekt kërkimor individual, që supervizohet nga dy udhëheqës dhe duhet të jetë e lidhur me fushën e tyre kërkimore dhe/ose të mësimdhënies. Studentët duhet të ndjekin seminarin e tezës që ka për qëllim të ndihmojë studentët të zhvillojnë tezën e tyre. Komisioni vlerësues konsiston në lektorë prej të gjitha universiteteve partnere (IAL) në të cilat studenti ka ndjekur studimet e tij/saj dhe në të njëjtën kohë janë lektorë që përfaqësojnë të dy modulet e ndjekura prej studentit/es.<sup>142</sup></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.7

<sup>141</sup> Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref.Nr.10)

<sup>142</sup> PoSIG\_Marreveshja e programit pika 4. Exams, Master’s Thesis and Master’s Thesis Defence (Ref. Nr. 7)

**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet. Shih pikën V.6.2 të këtij raporti. UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional. Aktualisht UET gëzon 95 marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë<sup>143</sup>. Pjesë e këtyre marrëveshjeve është edhe mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave.<sup>144</sup> Sa i përket programit PoSIG, mobiliteti i studentëve mes universiteteve partnere është i garantuar, pasi është kusht për përfundimin e studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Përfundimi i ciklit të dytë të studimeve master i shkencave, u mundëson studentëve, vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Studentët zhvillojnë lëndë të metodave të kërkimit që i ndihmojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre në kërkimin shkencor. Gjithashtu seminarët për shkrimin e Tezës së diplomës u vijnë në ndihmë për të plotësuar çdo mangësi, si edhe për të konkretizuar hapat dhe fazat që përshkon procesi i kërkimit shkencor.<sup>145</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Institucioni i ka të përcaktuara qartë politikat e përfshirjes së studiuesve të rinj, në projektet kërkimore. Për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor dhe ndër-disiplinaritetin, UET ka ndërtuar 11 Projekte të Mëdha Kërkimore (PMK), të cilat përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET. Këto projekte, drejtohen nga senior researchers dhe orientojnë punën kërkimore shkencore të Junior Researchers, në PMK-të ku bëjnë pjesë. Gjithashtu, nën PMK, janë grupet kërkimore, brenda të cilave do të strehohen dhe doktorantët e rinj.<sup>146</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>UET në sajë të bashkëpunimit me institucione të tjera homologe, rrit bashkëpunimin ndërmjet stafit dhe përfshirjes shkencore të tyre, dhe pjesëmarrjen e tyre në Konferencën e ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”, si keynote speaker, si referues etj.<sup>147</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së mobilitetit të studentëve, UET ndjek politika favorizuese për këta studentë, duke lehtësuar procedurat e procesit të shkëmbimit të studentëve. (<i>Urdhër Administrativ, nr.22, datë 24.11.2016</i>)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Sikurse u përmend edhe më sipër, UET fton personel akademik për t’u angazhuar në mësimdhënie ose për të marrë pjesë në konferencat shkencore që zhvillohen këtu. Gjithashtu në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit në</p>

<sup>143</sup> Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit (Ref. Nr. 34)

<sup>144</sup> Të dhëna mbi shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43.3)

<sup>145</sup> PoSIG\_curr-political-science\_final2017 (Ref. Nr. 14)

<sup>146</sup> Strategjia e kërkimit shkencor (2017-2020), pika 7 (Ref.Nr.3.1)

<sup>147</sup> DSSH (Ref. Nr. 55)

	kuadër të projekteve Erasmus + Credit Mobility, studentë të huaj kanë ardhur në UET për të kryer një semestër.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit<sup>148</sup>. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Edhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve.</p> <p>Dekani i Studentëve dhe ekipi i saj ndihmojnë studentët në zhvillimin e tyre personal, shoqëror dhe akademik, duke bërë të mundur një eksperiencë të studiuar sa më të mirë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndihmojnë studentët me orientimin dhe këshillimin.</li> <li>- Lehtësojnë aktivitetet e ndryshme në Universitet.</li> <li>- Ofrojnë mbështetje për Këshillin e Studentëve dhe Klubet Studentore.</li> <li>- Mbështesin jetën akademike duke krijuar grupe mësimore, tutoriate dhe dhënie instruksionesh.</li> <li>- Avokati për nevojat dhe interesin e studentëve.</li> <li>- Këshillimi i studentëve për angazhim.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kombinimi i aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit departament (referencë kriteri 1), janë tregues të ngritjes dhe mirëfunksionimit të një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Zyra e Karrierës kryen një sërë funksionesh të lidhura ngushtësisht me ofrimin e mundësive që studentët, gjatë kohës së studimeve, të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes për tu integruar lehtësisht në tregun e punës, por edhe ndjekjen e tyre pas studimeve. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik, por janë plotësues të njëra-tjetrës.</p> <p>UET organizon çdo vit Panairin e Punës. Në të marrin pjesë rreth 60 kompani, më të mëdhatë në Shqipëri, të cilat zhvillojnë intervista pune me studentët e UET. Rreth 25% e studentëve që kanë marrë pjesë në Panairin e Punës të</p>

<sup>148</sup> Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

	<p>organizuar nga UET, janë punësuar në kompanitë pjesëmarrëse.</p> <p>Open-Day është një tjetër aktivitet i UET që i shërben pikërisht zhvillimit të karrierës dhe mundësimit të punësimit të studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë<sup>149</sup>. Në këtë kuadër, studentë Alumni janë të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit vazhdojnë të qëndrojnë në themel dhe të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese dhe personelit<sup>150</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve <i>ad hoc</i>, dhe që nga Janari 2011 në</p>

<sup>149</sup> <http://uet.edu.al/new/uet-alumni-10-vite-me-pas/>

<sup>150</sup> Statuti UET, Neni 11 & 16 (Ref. Nr. 2); Rregullore UET, Neni 6 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)



<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit<sup>151</sup>. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ngritja e organeve këshilluese si Bordet e Tregut të Punës, sikurse dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. Strukturë tjetër e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë është dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), roli i së cilës është të zhvillojë politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UET, si edhe të monitorojë zbatueshmërinë korrekte të tyre nga njësitë akademike dhe administrative.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, ZCS, KSBC-së, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Universiteti Europian i Tiranës i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe periodik institucional (me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike) sikurse dhe të programeve të studimit, kontrollit të ligjshmërisë të ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET i plotësonte standardet dhe kriteret ligjore; vizitat monitoruese të MASR mbi kapacitetet akademik dhe infrastrukturore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Veprimtarinë e saj KSBC-ja e mbështet në dokumente strategjik<sup>152</sup> dhe e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse<sup>153</sup>. Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njëjësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<sup>151</sup> Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

<sup>152</sup> Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3); Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Ref. Nr. 30.2)

<sup>153</sup> Plani Veprimit\_KSBC\_2018-2019 (Ref. Nr. 30.1)

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	KSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimi e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç KSBC-së kanë Departamentet si njësi përgjegjëse për programin e studimit, ku përgjegjësit e grup-lëndëve/kordinatorët e programeve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Bordet e tregut të punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikat dhe kërkesat që vijnë nga tregu. Këto rekomandime bëhen bazë për ndryshime në kurrikula në funksion të përshtatjes sa më mirë me këto kërkesa.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar <sup>154</sup> . Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	UET përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga KSBC, për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve <sup>155</sup> . Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë KSBC.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj <sup>156</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë <sup>157</sup> . KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive.

<sup>154</sup> Metodologjia e punës së KSBC-së\_Provimet (Ref. Nr. 30.5); Format Raporti\_Provimet (Ref. Nr. 30.6)

<sup>155</sup> Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset (Ref. Nr. 30.7)

<sup>156</sup> Formatit i relacionit mbi përputhshmërinë e silabuseve (Ref. Nr. 37)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi nga KSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta, të drejtpërdrejta si dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Disa prej metodave që UET përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë monitorimi i elementëve të lidhur me proceset akademike si provimet, silabuset, literatura e përdorur, etj. Një vend të veçantë zë dhe përfshirja e studentëve në këto procese. Në strukturën e KSBC është një përfaqësues i Këshillit të Studentëve. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara,</p>	<p>UET, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teste të standardizuara;</li> <li>• Dëgjime në auditor;</li> <li>• Vlerësimi me pikë;</li> <li>• Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>• Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët;</li> <li>• Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</li> </ul> <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eprori (Përgjegjësi/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi<sup>158</sup>.</p>

<sup>158</sup> G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref. Nr. 30.8)

rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët <sup>159</sup> . Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre. Të tërthorta: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve,</li> <li>• Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>• Pyetje konceptuale;</li> <li>• Intervista.</li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: red; color: white;">Nuk përmbushet</td> <td style="background-color: orange;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: yellow;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: green;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Ngritja e organeve këshilluese si Bordet e Tregut të Punës, sikurse dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS 'ENCHASE' <sup>160</sup> dhe Erasmus+ <i>QAINAL</i> <sup>161</sup> ). Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe

<sup>159</sup> G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

<sup>160</sup> Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9)

<sup>161</sup> Fisha e projektit FINAC (Ref. Nr. 30.10)

	vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit të përmendura në kriteret e mësipërme.			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në dokumentin që rregullon veprimtarinë e lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar <sup>162</sup> . Komisioni i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme: a) Kompetencat profesionale; b) Paanshmëria; c) Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe d) Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; e) Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Angazhimi i ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, takimet me Bordin e Tregut të Punës, pjesëmarrja në projekte të lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë janë tregues të angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<sup>162</sup> Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Raporti në tërësi i shpërndahet drejtuesve, ndërsa në departamente diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë departament. Në ato raste kur të dhënat vlerësohen se kanë një sensibilitet të lartë, rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të follow up-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik<sup>163</sup>. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve trajnuese dhe deri tek masat konkrete për pedagogët të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme.</p> <p>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuar kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor;</li> <li>• Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu edhe jashtë vendit;</li> <li>• Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të shkëmbimit të stafit nëpërmjet përfshirjes në programin Erasmus+.</li> </ul>

<sup>163</sup> G-I-12-1 Formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik (Ref. Nr. 41)

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Të gjithë dokumentet, procedurat dhe instrumentet e përmendura në kriteret e mësipërme dëshmojnë faktin se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë por edhe në mënyrë të tërthortë duke qenë se veprimtaria i bëhet e ditur si stafit akademik ashtu edhe studentëve. Informacioni për studentët shpërndahehtë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulloreve;</li> <li>• Studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (KSBC, Senat Akademik);</li> <li>• Këshillit të studentëve;</li> <li>• Javës së orientimit (e cila zhvillohet në fillim të vitit akademik).</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë, Programi i përbashkët Master i Shkencave “Shkenca Politike: Integrimi dhe Qeverisja të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”, i ofruar në bashkëpunim me 8 institucione të tjera partnere**

**Pikat e forta dhe afirmime**

- 1) Ndërkombëtarizimi është padyshim pika më e fortë e programit. Studentët kanë mundësi të ndjekin studimet në të paktën 2 deri në 3 universitete të ndryshme. Studimi në Austri apo Slloveni i pajis me një kuadër të fortë teorik dhe metodologjik dhe studimi në një universitet të Ballkanit i jep përveç cilësisë së mësimdhënies një njohje shumë të mirë të rajonit.
- 2) Pajisja e studentit me një diplomë nga 2 (dy) ose 3 (tre) universitete, në varësi të rrugëtimit që ka ndjekur për të kryer studimet.
- 3) Cilësia shumë e mirë e stafit duke patur parasysh jo vetëm formimin teorik shumë të mirë të stafit pedagogjik, por edhe përvojën e tyre të pasur në projekte, programe dhe bashkëpunime me karakter aplikativ të dijes;
- 4) Organizmi i programit me module i jep mundësi studentëve të fitojnë njohuri më të gjera se sa në një Master tjetër që i profilizon thjesht në një disiplinë.
- 5) Perfeksionimi i gjuhës Angleze, dhe njohja e diplomës nga universitete perëndimore rrisin tregun e punës së studentit duke e bërë këtë treg më ndërkombëtar.
- 6) Format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve, të cilat mundësojnë testimin e studentëve si për njohuritë e marra, ashtu dhe për aftësitë analitike dhe argumentuese, duke kombinuar në këtë mënyrë testimin e gjerësisë me atë të thellësisë së dijes;
- 7) Kërkimi shkencor, në funksion të të cilit UET ka ngritur revistat e veta shkencore ndërkombëtare si Polis; por edhe mbështetja financiare nga ana e UET e projekteve kërkimore-shkencore individuale e vendosin kërkimin shkencor si pikën kryesore të axhendës akademike të pedagogëve;
- 8) Imazhi i mirë i UET-it në publik, imazh ky i krijuar prej karrierës së suksesshme të studentëve të mëparshëm të UET, nga kujdesi i vazhdueshëm i UET për t'i ndihmuar studentët përmes praktikave profesionale dhe bordeve të tregut të punës, por edhe nga fakti që një numër i konsiderueshëm i stafit pedagogjik të përfshirë në këtë program studimi janë pjesëmarrës aktivë në debatin publik në median e shkruar dhe vizive.
- 9) Zgjerimi i bashkëpunimit me institucione të tjera akademike ndërkombëtare;
- 10) Emri dhe imazhi pozitiv publik i UET në Shqipëri dhe në rajon mund të ndikojë në përzgjedhjen e mëtejshme të UET-it si një universitet elitare dhe në këtë kuadër edhe të programit të PoSIG.
- 11) Arritjet e UET-it në ciklin e dytë (Master) mund të rrisin prirjen për besim të publikut ndaj sektorit privat të arsimit të lartë.

**Pika të dobëta**



- 1) Përfshirja e studentëve në veprimtarinë kërkimore-shkencore të UET-it nuk është ende në nivelin e synuar me objektivat e UET-it;
- 2) Numri i studentëve që ndjekin studimet për një semestër në UET është i vogël, duke qenë se studentët që e ndjekin studimet në vitin e parë në Salszburg dhe Lubjanë, më pas shpërndahen në të gjitha universitetet partnere. Gjë që shpjegon edhe pse UET ka patur një student gjatë vitit 2018-2019.
- 3) Konkurrenca e programit brenda dhe jashtë UET nga degët me tërheqje më masive. Disa degë të tjera, si p.sh. ekonomiku, juridiku, mjekësia, apo psikologjia cilësohen nga publiku ose si më të kërkuara në treg, ose si degë që të sjellin të ardhura materiale më shumë dhe më shpejt.
- 4) Vështirësia e diversifikimit të burimeve të financimit, që mbart rrezikun e vështirësisë së financimit të programeve në UET, si institucion i vetëfinancuar në tregun shqiptar të arsimit.

## Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti UET
3. Plani Strategjik 2015-2020;
  - 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020;
4. EuroPS\_Dissemination\_Strategy\_12102016
5. Rregullore UET
6. Dokumenti F.IV-F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit;
7. PoSIG\_Marreveshja e programit
  - 7.1 Dokumenti A.IV. Sistemi i vleresimit te studenteve
  - 7.2 Partnership Agreement University of Salzburg - UET (EN)
  - 7.3 Albanien\_UET\_SBG\_signed
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë;
  - 8.1 HandbookQualityManagement
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore;
10. Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit;
  - 10.1 Kalendar Akademik 2018-2019
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore;
  - 11.1 Shembull thirrje për staf akademik
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit;
  - 12.1 Bordi i Tregut te Punes
  - 12.2 Poster panairi i punes 2019
13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave;
14. PoSiG\_curr-political-science\_final\_2017
  - 14.1 Plani mesimor i programit PoSIG
15. Modeli i diplomës; Modeli i Suplementit të Diplomës;
16. PoSIG \_Studim\_Tregu
17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve e **(nuk ekziston pasi është programi i ri)**;
18. Plotësimi i rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe/ose akreditimi i mëparshëm **(nuk ka pasi akreditohet për herë të parë)**;
19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite;
  - 19.1 Format i Syllabusit Cikli i pare dhe dyte (A1)
  - 19.2 A-III-8-2 Indikatoret e vleresimit te programit te lendes
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit).
22. CV e stafit ndihmës akademik (Nuk ka)
23. Te dhena tabelore per personelin e njesise kryesore dhe baze
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit
25. Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha programet e studimit;

26. Të dhëna për numrin e programeve të ofruara nga njësia bazë;
27. Të dhëna për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje
  - 27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve
28. Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin;
29. Dokumenti D.III. Mbi përfshirjen e studenteve në qeverisjen e UET
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
  - 30.1 Plani Veprimit\_KSBC\_2018-2019
  - 30.2 Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë;
  - 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020;
  - 30.4 Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC;
  - 30.5 Metodologjia e punës së KSBC\_Provimit;
  - 30.6 Format\_Raporti për provimet;
  - 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset;
  - 30.8 G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu;
  - 30.9 Fisha e projektit Enchase;
  - 30.10 Fisha e projektit QAinAL;
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane; **(nuk kanë dalë ende aktet nga MASR);**
32. PoSIG\_Institucionet në funksion të realizimit të praktikës profesionale;
  - 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të mëtejshme, për studentët e diplomuar **(nuk ka ende, program i ri);**
34. UET Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
  - 34.1 EuroPS\_Consolidated\_Stakeholders\_DB\_28112016
35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve **(nuk ka, program i ri);**
36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit;
37. Format i relacionit për monitorimin e silabuseve;
38. Raport rreth zbatimit të projektit;
39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës;
40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët
  - 40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve \_ Departamenti
41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik;
42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit;
43. Puna kerkimore shkencore e stafit të dept 2018-2019;
  - 43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS;
  - 43.2 Projekte UET 2011-2018
  - 43.3 Të dhëna mbi shkëmbimin e stafit;
44. Format Dosje staf akademik me kohë të plotë;
  - 44.1 Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme;

45. Inventari i teksteve\_Shkenca Politike\_MN; Te dhena statistikore per fondin e Bibliotekes
  - 45.1 E-IV-2 Formular per pasurimin e fondit te librave ne biblioteke;
  - 45.2 Shembull procedure\_blerje literature;
  - 45.3 Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës
46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS;
  - 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS;
  - 46.2 UET LMS Guide per pedagogun;
  - 46.3 UET LMS Guide per studentet;
  - 46.4 Teaching Handbook\_PoSIG
47. Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës [www.uet.edu.al](http://www.uet.edu.al);
48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online;
49. Të dhëna mbi koston për student;
50. Të ardhura dhe financime të ndryshme;
51. Komunikimi i intergruar i marketingut;
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (**Nuk ka patur**);
53. Ligji dhe akte nënligjore;
54. Licencime dhe akreditime;
55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)
56. Kodi i Etikës.